



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

Nr. 100/436 Regjistri.

VENDIM

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

**SOKOL SADUSHI
ERVIN PUPE
ILIR PANDA**

**KRYESUES
ANËTAR
ANËTAR**

Sot më datë 04.05.2020, mori në shqyrtim në dhomë këshillimi kërkesën Nr. 2345 Prot., datë 19.09.2019, si më poshtë:

KËRKUES: **MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË**

PADITËS: **Z. ADMIR BARIU**

I PADITUR: **MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DEGA E THESARIT TIRANË**

PERSON I TRETË: **PROKURORIA E RRETHIT GJYQËSOR TIRANË**

OBJEKTI: Pezullimin e ekzekutimit të Vendimit nr. 4029, datë 09.11.2018 të Gjykatës Administrative të Apelit.

BAZA LIGJORE: Neni 479 i Kodit të Procedurës Civile.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me Vendimin Nr. 2836 (80-2016-2839), date 06.06.2016 ka vendosur ndër të tjera: *“Pranimin pjesërisht të kërkesës – padisë së paditësit, Admir Bariu. – Kompensimin për burgim të padrejtë të paditësit, Admir Bariu, për 60 ditë paraburgim. – Detyrimin e palës së paditur, Ministria e Financave dhe Dega e Thesarit Tiranë, për të kompensuar paditësin, Admir Bariu, me kompensimin në shumën 90.000 Lekë.”.*

Gjykata Administrative e Apelit me Vendimin nr. 4029, datë 09.11.2018 ka vendosur: *“- Ndryshimin e Vendimit nr. 2836, datë 06.06.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. – Pranimin e pjesëshëm të padisë. – Detyrimin e palës së paditur të kompensojë paditësin në vlerën 63.000 Lekë për 42 ditë paraburgim.”.*

Kundër Vendimit nr. 4029, datë 09.11.2018 të Gjykatës Administrative të Apelit ka ushtruar rekurs pala e paditur, Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Në rekurs është kërkuar ndryshimi i vendimeve të të dy gjykatave të faktit dhe rrëzimi i padisë si e pabazuar në ligj.

Me datë 26.09.2019 Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë. Në kërkesë parashtrohet se:

- *Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka ushtruar rekurs kundër vendimit dhe çështja pritët të gjykohet në Gjykatën e Lartë;*
- *Ekzekutimi i detyrueshëm i titullit ekzekutiv ka nisur dhe se ka rrezik që vendimi të ekzekutohet edhe pse është marrë në kundërshtim me ligjin;*
- *Vlera që pala paditëse ka përfituar si kompensim nga gjykatat nuk i përgjigjet kriterëve ligjore dhe provave që ka fashikulli;*
- *Nëse vendimi gjyqësor ekzekutohet atëhere do të rrezikohet veprimtaria e institucionit dhe nuk do munden të përmbushen shërbimet dhe detyrimet ligjore kundrejt qytetarëve;*
- *Nuk ka buxhet të planifikuar për ekzekutimin e këtij vendimi gjyqësor dhe se vendimi duhet të pezullohet, deri në shqyrtimin e rekursit nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë.*

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoi relatimin e gjyqtarit, z. **Sokol Sadushi**, mbi kërkesën e pezullimit të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë,

VËREN:

1. FAKTET E ÇËSHTJES

1. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me Vendimin Nr. 2836 (80-2016-2839), datë 06.06.2016 ka vendosur ndër të tjera: “*Pranimin pjesërisht të kërkesës – padisë së paditësit, Admir Bariu. – Kompensimin për burgim të padrejtë të paditësit, Admir Bariu, për 60 ditë paraburgim. – Detyrimin e palës së paditur, Ministria e Financave dhe Dega e Thesarit Tiranë, për të kompensuar paditësin, Admir Bariu, me kompensimin në shumën 90.000 Lekë.*”.

2. Gjykata Administrative e Apelit me Vendimin nr. 4029, datë 09.11.2018 ka vendosur: “- *Ndryshimin e Vendimit nr. 2836, datë 06.06.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. – Pranimin e pjesshëm të padisë. – Detyrimin e palës së paditur të kompensojë paditësin në vlerën 63.000 Lekë për 42 ditë paraburgim.*”.

3. Kundër Vendimit nr. 4029, datë 09.11.2018 të Gjykatës Administrative të Apelit ka ushtruar rekurs pala e paditur, Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Në rekurs është kërkuar ndryshimi i vendimeve të të dy gjykatave të faktit dhe rrëzimi i padisë si e pabazuar në ligj.

4. Me datë 26.09.2019 Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë. Në kërkesë parashtrohet se:

- *Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka ushtruar rekurs kundër vendimit dhe çështja pritët të gjykohet në Gjykatën e Lartë;*
- *Ekzekutimi i detyrueshëm i titullit ekzekutiv ka nisur dhe se ka rrezik që vendimi të ekzekutohet edhe pse është marrë në kundërshtim me ligjin;*
- *Vlera që pala paditëse ka përfituar si kompensim nga gjykatat nuk i përgjigjet kriterëve ligjore dhe provave që ka fashikulli;*
- *Nëse vendimi gjyqësor ekzekutohet atëhere do të rrezikohet veprimtaria e institucionit dhe nuk do munden të përmbushen shërbimet dhe detyrimet ligjore kundrejt qytetarëve;*

- Nuk ka buxhet të planifikuar për ekzekutimin e këtij vendimi gjyqësor dhe se vendimi duhet të pezullohet, deri në shqyrtimin e rekursit nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë.

5. Rezulton se përmbareusi gjyqësor ka realizuar njoftimin e debitorit për ekzekutimin vullnetar e më tej ka nisur ekzekutimi i detyrueshëm. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur të procedojë me njoftimin e palëve për kërkesën e palës së paditur për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë.

2. VLERËSIMI I KOLEGJIT ADMINISTRATIV TË GJYKATËS SË LARTË

6. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

7. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atëçastshëm dhe eminent për shkakimin e një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

8. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:

- a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme; dhe/ose
- b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.

9. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të pariparueshëm dhe të atëçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;
- (nuk) cenohet rëndë interesi publik.

10. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të inicuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

11. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentat e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim.

12. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore pasjell mospranimin e kërkesës për pezullim. Nga ana tjetër abuzimi me mjetin ligjor të parashkuar nga neni 479 i Kodit të Procedurës Civile mund të shkaktojë dhe aktivizimin e përgjegjësisë personale pasurore të palës apo përfaqësuesit, sipas pikës 1 të nenit 34 të Kodit.

13. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë është e pabazuar në ligj dhe si e tillë nuk duhet të pranohet. Gjykata e Lartë konstaton se shkaqet e rekursit janë paraqitur si shkaqe të kërkesës për pezullimin e vendimit të formës së prerë dhe për rrjedhojë kërkesa për pezullim nuk paraqet shkaqe të përligjura dhe që mundet të shqyrtohen në këtë gjykim të posaçëm të masave të përkohshme procedurale. Nga ana tjetër pala kërkuese nuk ka paraqitur argumentet dhe provat konkrete për vërtetimin e dëmit të riparueshëm dhe të atëçastshëm që palës debitore mund t'i vijë nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Për rrjedhojë Kolegji konkludon se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë nuk mund të pranohet, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile.

Për këto arsye:

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë mbështetur në Nenin 479 të Kodit të Procedurës Civile,

Vendosi:

Mospranimin e kërkesës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për pezullimin e ekzekutimit të Vendimit Nr. 2836 (80-2016-2839), datë 06.06.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, që është ndryshuar me Vendimin nr. 4029, datë 09.11.2018 të Gjykatës Administrative të Apelit.

Tiranë, me datë 04.05.2020

ANËTAR

ANËTAR

KRYESUES

ILIR PANDA

ERVIN PUPE

SOKOL SADUSHI



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

Nr. 104/441 Regjistri.

VENDIM

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

**SOKOL SADUSHI
ERVIN PUPE
ILIR PANDA**

**KRYESUES
ANËTAR
ANËTAR**

Sot më datë 04.05.2020, mori në shqyrtim në dhomë këshillimi kërkesën Nr. 2371 Prot., datë 30.09.2019, si më poshtë:

KËRKUES: **MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË**

PADITËS: **Z. AFRIM HOXHA**

I PADITUR: **MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DEGA E THESARIT TIRANË**

PERSON I TRETË: **PROKURORIA PRANË RRETHIT GJYQËSOR TIRANË**

OBJEKTI: Kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të Vendimit nr. 2180 (86-2019-2505), datë 10.07.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

BAZA LIGJORE: Neni 479 i Kodit të Procedurës Civile.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me Vendimin nr. 4524, datë 21.11.2017 ka vendosur: “- *Pranimin e padisë. – Detyrimin e palëve të paditura, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Dega e Thesarit Tiranë, të kompensojë paditësin për qendrimin në paraburgim në masën totale prej 6.213.000 Lekë. – Shpenzimet gjyqësore të provuara si të paguara të palës paditëse i ngarkohen në total palës së paditur.*”.

Gjykata Administrative e Apelit me Vendimin nr. 2180 (86-2019-2505), datë 10.07.2019 ka vendosur: “*Lënie në fuqi të Vendimit nr. 4524, datë 21.11.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.*”.

Me datë 01.08.2019 pala e paditur, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka ushtruar rekurs kundër vendimit të gjykatës së apelit, duke parashtruar edhe shkaqet respektive të kundërshtimit ligjor.

Me datë 30.09.2019 pala e paditur, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë. Në kërkesë parashtrohet se:

- *Ndaj vendimit të gjykatës së apelit është ushtruar rekurs dhe pritet të vendosë Gjykata e Lartë;*
- *Ekziston domosdoshmëria e marrjes së masës së pezullimit, pasi ka urgjencë dhe sengarkimi i palës së paditur me këtë detyrim financiar do të rrezikonte funksionimin e institucionit;*
- *Vendimet e gjykatave të faktit janë të pambështetura në prova dhe në ligj dhe masa e dëmshpërblimit është e madhe dhe vështirësisht e rikuperueshme në rast një vendimmarrje të ndryshme nga Gjykata e Lartë;*
- *Vendimi duhet të pezullohet, deri në shqyrtimin e rekursit nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë.*

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoji relatimin e gjyqtarit, z. **Sokol Sadushi**, mbi kërkesën e pezullimit të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë,

VËREN:

1. FAKTET E ÇËSHTJES

1. **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me Vendimin nr. 4524, datë 21.11.2017** ka vendosur: “- *Pranimin e padisë. – Detyrimin e palëve të paditura, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Dega e Thesarit Tiranë, të kompensojë paditësin për qendrimin në paraburgim në masën totale prej 6.213.000 Lekë. – Shpenzimet gjyqësore të provuara si të paguara të palës paditëse i ngarkohen në total palës së paditur.*”.

2. **Gjykata Administrative e Apelit me Vendimin nr. 2180 (86-2019-2505), datë 10.07.2019** ka vendosur: “*Lënien në fuqi të Vendimit nr. 4524, datë 21.11.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.*”.

3. Me datë 01.08.2019 pala e paditur, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka ushtruar rekurs kundër vendimit të gjykatës së apelit, duke parashtruar edhe shkaqet respektive të kundërshtimit ligjor.

4. **Me datë 30.09.2019 pala e paditur, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë. Në kërkesë parashtrohet se:**

- *Ndaj vendimit të gjykatës së apelit është ushtruar rekurs dhe pritet të vendosë Gjykata e Lartë;*
- *Ekziston domosdoshmëria e marrjes së masës së pezullimit, pasi ka urgjencë dhe sengarkimi i palës së paditur me këtë detyrim financiar do të rrezikonte funksionimin e institucionit;*
- *Vendimet e gjykatave të faktit janë të pambështetura në prova dhe në ligj dhe masa e dëmshpërblimit është e madhe dhe vështirësisht e rikuperueshme në rast një vendimmarrje të ndryshme nga Gjykata e Lartë;*
- *Vendimi duhet të pezullohet, deri në shqyrtimin e rekursit nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë.*

5. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur të procedojë me njoftimin e palëve për kërkesën e palës së paditur për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë. Ekzekutimi i detyrueshëm i titullit ekzekutiv ka nisur.

2. VLERËSIMI I KOLEGJIT ADMINISTRATIV TË GJYKATËS SË LARTË

6. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

7. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atçastshëm dhe eminent për shkakimin e një dëmi të rëndë dhe të riparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

8. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:

a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të riparueshme; dhe/ose

b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.

9. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të riparueshëm dhe të atçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;
- (nuk) cenohet rëndë interesi publik.

10. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të inicuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

11. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar

dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentat e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim.

12. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim. Nga ana tjetër abuzimi me mjetin ligjor të parashikuar nga neni 479 i Kodit të Procedurës Civile mund të shkaktojë dhe aktivizimin e përgjegjësisë personale pasurore të palës apo përfaqësuesit, sipas pikës 1 të nenit 34 të Kodit.

13. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë është e pabazuar në ligj dhe si e tillë nuk duhet të pranohet. Gjykata e Lartë konstaton se shkaqet e rekursit janë paraqitur si shkaqe të kërkesës për pezullimin e vendimit të formës së prerë dhe për rrjedhojë kërkesa për pezullim nuk paraqet shkaqe të përligjura dhe që mundet të shqyrtohen në këtë gjykim të posaçëm të masave të përkohshme procedurale. Nga ana tjetër pala kërkuese nuk ka paraqitur argumentet dhe provat konkrete për vërtetimin e dëmit të pariparueshëm dhe të atëçastshëm që palës debitore mund t'i vijë nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Për rrjedhojë Kolegji konkludon se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë nuk mund të pranohet, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile.

PËR KËTO ARSYE:

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë mbështetur në Nenin 479 të Kodit të Procedurës Civile,

VENDOSI:

Mospranimin e kërkesës së palës së paditur, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, për pezullimin e ekzekutimit të Vendimit nr. 2180 (86-2019-2505), datë 10.07.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit.

Tiranë, me datë 04.05.2020

ANËTAR

ILIR PANDA

ANËTAR

ERVIN PUPE

KRYESUES

SOKOL SADUSHI



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

Nr. 206 Regj.

**V E N D I M
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i përbërë nga:

Sokol Sadushi	Kryesues
Ervin Pupe	Anëtar
Ilir Panda	Anëtar

në Tiranë, sot më datë **04.05.2020**, mori në shqyrtim kërkesën për pezullim, në çështjen administrative me Nr. **Akti 206/2020**, që i përket:

KËRKUES: Agjencia Shtetërore e Kadastrës.

PALËT NDËRQYQËSE:

PADITËS: Fatmir Alla.

TË PADITUR: Ministria e Drejtësisë.
Agjencia Shtetërore e Kadastrës.

OBJEKTI: Pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 1264 (997), datë 19.11.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, lënë në fuqi me vendimin nr. 1303, datë 25.04.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit.

BAZA LIGJORE: Neni 479/a i Kodit të Procedurës Civile.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës, me vendimin nr. 1264 (997), datë 19.11.2015, ka vendosur:

- *Pranimin e padisë pjesërisht.*
- *Detyrimin e të paditurve, Ministria e Drejtësisë dhe ZQRPP Tiranë, të shpërblejnë dëmin e shkaktuar paditësit, Fatmir Alla si pasojë e zgjidhjes së menjëhershme dhe të pajustifikuar të kontratës së punës, në masën e 10 (dhjetë) pagave mujore.*
- *Detyrimin e të paditurve, Ministria e Drejtësisë dhe ZQRPP Tiranë, të shpërblejnë dëmin e shkaktuar paditësit, Fatmir Alla për mosrespektimin e afatit të njoftimit, në masën e 3 (tre) pagave mujore.*
- *Detyrimin e të paditurve, Ministria e Drejtësisë dhe ZQRPP Tiranë, të shpërblejnë dëmin e shkaktuar paditësit, Fatmir Alla për mosrespektimin e procedurës së njoftimit me 2 (dy) paga mujore.*

- *Detyrimin e të paditurve, Ministria e Drejtësisë dhe ZQRPP Tiranë, të shpërblejnë dëmin e shkaktuar paditësit, Fatmir Alla për vjetërsinë në punë, në masën e 3 (tre) paga mujore dhe një 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh pagë.*
- *Për efekt të llogaritjes së pagës sipas këtij vendimi, të merret paga mujore bruto 92.720 (nëntëdhjetë e dy mijë e shtatëqind e njëzet) lekë.*
- *Rrëzimin e padisë pjesërisht për kërkimet e tjera.*
- *Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të paditurve, Ministria e Drejtësisë dhe ZQRPP Tiranë.*

Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 1303, datë 25.04.2019, ka vendosur:

- *Lënien në fuqi të vendimit nr. 1264 (997), datë 19.11.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës.*

Kundër vendimit nr. 1303, datë 25.04.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit, ka paraqitur rekurs pala e paditur, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, e cila ka kërkuar ndryshimin e këtij vendimi si dhe të vendimit nr. 1264 (997), datë 19.11.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, dhe rrëzimin e padisë.

Pala e paditur, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, në datën 17.03.2020, ka paraqitur përpara Gjykatës së Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 276 (296), datë 04.03.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, ndryshuar me vendimin nr. 2747, datë 17.10.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit, duke parashtruar këto shkaqe:

- Ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda financiare për institucionin tonë.

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoi relacionin e gjyqtarit Sokol Sadushi dhe si e shqyrtoi çështjen në tërësi, në dhomë këshillimi, pa pjesëmarrjen e palëve;

V Ë R E N

Paditësi, përgjatë periudhës 30.05.2006 – 05.02.2013, ka ushtruar detyrën e Regjistruarit të Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Librazhd.

Me urdhrin nr. 802/1, datë 05.02.2013, të Ministrit të Drejtësisë, paditësit rezultoi të jetë zgjidhur kontrata e punës me efekte të menjëhershme financiare, pa motivacion.

Duke mos qenë dakord me sa më sipër, paditësi ka paraqitur një padi përpara Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, duke kërkuar dëmshpërblimin për zgjidhjen e menjëhershme dhe të pajustificuar të kontratës së punës, për mosrespektimin e procedurës si dhe shpërblimin për vjetërsi në punë.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës, me vendimin nr. 1264 (997), datë 19.11.2015, ka vendosur:

- *Pranimin e padisë pjesërisht.*
- *Detyrimin e të paditurve, Ministria e Drejtësisë dhe ZQRPP Tiranë, të shpërblejnë dëmin e shkaktuar paditësit, Fatmir Alla si pasojë e zgjidhjes së menjëhershme dhe të pajustificuar të kontratës së punës, në masën e 10 (dhjetë) pagave mujore.*

- Detyrimin e të paditurve, Ministria e Drejtësisë dhe ZQRPP Tiranë, të shpërblejnë dëmin e shkaktuar paditësit, Fatmir Alla për mosrespektimin e afatit të njoftimit, në masën e 3 (tre) pagave mujore.
- Detyrimin e të paditurve, Ministria e Drejtësisë dhe ZQRPP Tiranë, të shpërblejnë dëmin e shkaktuar paditësit, Fatmir Alla për mosrespektimin e procedurës së njoftimit me 2 (dy) paga mujore.
- Detyrimin e të paditurve, Ministria e Drejtësisë dhe ZQRPP Tiranë, të shpërblejnë dëmin e shkaktuar paditësit, Fatmir Alla për vjetërsinë në punë, në masën e 3 (tre) paga mujore dhe një 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh pagë.
- Për efekt të llogaritjes së pagës sipas këtij vendimi, të merret paga mujore bruto 92.720 (nëntëdhjetë e dy mijë e shtatëqind e njëzet) lekë.
- Rrëzimin e padisë pjesërisht për kërkimet e tjera.
- Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të paditurve, Ministria e Drejtësisë dhe ZQRPP Tiranë.

Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 1303, datë 25.04.2019, ka vendosur:

- Lënien në fuqi të vendimit nr. 1264 (997), datë 19.11.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës.

Kundër vendimit nr. 1303, datë 25.04.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit, ka paraqitur rekurs pala e paditur, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, e cila ka kërkuar ndryshimin e këtij vendimi si dhe të vendimit nr. 1264 (997), datë 19.11.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, dhe rrëzimin e padisë.

Pala e paditur, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, në datën 17.03.2020, ka paraqitur përpara Gjykatës së Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 276 (296), datë 04.03.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, ndryshuar me vendimin nr. 2747, datë 17.10.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit, duke parashtruar shkaqet e prezantuara në pjesën hyrëse të këtij vendimi.

Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atëçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të riparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:

a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të riparueshme; dhe/ose

b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.

Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të riparueshëm dhe të atëçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;
- (nuk) cenohet rëndë interesi publik.

Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të iniciuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumenta konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentet e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim.

Së pari, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë konstaton se nga ana e kërkuesit është bërë rekurs ndaj vendimit nr. 1303, datë 25.04.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit, si kushti që e legjitimon këtë subjekt për paraqitjen e kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit të formës së prerë.

Së dyti, ky Kolegj konstaton se kërkesa e paraqitur nga pala e paditur, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 1264 (997), datë 19.11.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, lënë në fuqi me vendimin nr. 1303, datë 25.04.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit, nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 479 të Kodit të Procedurës Civile.

Në kërkesën e paraqitur prej tij, kërkuesi parashtron vetëm një shkak gjenerik, pasojat e rënda financiare që do të paraqiste për të ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit, pa dhënë shpjegime dhe argumente se cilat do të ishin këto pasoja konkrete financiare dhe se në ç’mënyrë do të shkaktoheshin nga ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit. Kërkesa për pezullimin e ekzekutimit të një vendimi të formës së prerë duhet t’i referohet një shkaku konkret, i cili duhet të arsyetohet mjaftueshëm nga ana e kërkuesit.

Në të njëjtën kohë, kërkuesi nuk ka paraqitur asnjë provë në mbështetje të pretendimit të tij. Ardhja e pasojave me natyrë financiare është një fakt i provueshëm. Për më tepër, referuar nenit 12 të Kodit të Procedurës Civile, pala që pretendon një të drejtë ka detyrimin të provojë faktet mbi të cilat ajo mbështet pretendimet e saj.

Për sa u parashtrua më sipër, kërkesa e paraqitur nga pala kërkuese, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 1264 (997), datë 19.11.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, lënë në fuqi me vendimin nr. 1303, datë 25.04.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit, nuk plotëson kriteret e parashikuara në nenin 479 të Kodit të Procedurës Civile dhe për këtë shkak duhet të vendoset mospranimi i saj.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, bazuar në nenin 479 të Kodit të Procedurës Civile;

V E N D O S I

Mospranimin e kërkesës së palës së paditur, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 1264 (997), datë 19.11.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, lënë në fuqi me vendimin nr. 1303, datë 25.04.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit.

Tiranë, më 04.05.2020

A N Ë T A R
Ilir PANDA

A N Ë T A R
Ervin PUPE

K R Y E S U E S
Sokol SADUSHI



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

Nr. 16/271 Regjistri.

VENDIM

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

**SOKOL SADUSHI
ERVIN PUPE
ILIR PANDA**

**KRYESUES
ANËTAR
ANËTAR**

Sot më datë 04.05.2020, mori në shqyrtim në dhomë këshillimi kërkesën Nr. 1400 Prot., datë 07.05.2019, si më poshtë:

KËRKUES: **MINISTRIA E MBROJTJES**

PADITËS: **ZNJ. ALBANA SPAHIU**

I PADITUR: **MINISTRIA E MBROJTJES**

OBJEKTI: Pezullimin e ekzekutimit të Vendimit nr. 2095, datë 29.04.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, ndryshuar me Vendimin nr. 430, datë 14.02.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit.

BAZA LIGJORE: Neni 479 i Kodit të Procedurës Civile.

Gjykata Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me Vendimin nr. 2095, datë 29.04.2016 ka vendosur: “*1. Rrëzimin e kërkesë padisë si të pabazuar në ligj dhe në prova.*”.

Gjykata Administrative e Apelit me Vendimin nr. 430, datë 14.02.2019 ka vendosur: “- *Ndryshimin e Vendimit nr. 2095 (80-2016-2088), datë 29.04.2016 të Gjykatës Administrative e Shkallës së Parë në këtë mënyrë: - Pranimin e padisë së paditëses Albana Spahiu. – Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ Vendimit nr. 68, datë 08.01.2014 për kalimin në listë të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mbrojtjes. – Kthimin e paditëses, Albana Spahiu, në vendin e mëparshëm të punës kthimin e saj në një pozicion pune të barazvlefshëm me të. – Detyrimin e palës së paditur, Ministria e Mbrojtjes, t’i paguajë paditëses, Albana Spahiu, pagën nga data e kalimit në listë pritje deri në datën e kthimit në detyrë.*”.

Kundër Vendimit nr. 430, datë 14.02.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit ka ushtruar rekurs pala e paditur, Ministria e Mbrojtjes. Në rekurs është kërkuar prishja e vendimit të gjykatës së apelit dhe rrëzimin e padisë si të pabazuar në ligj.

Me datë 07.05.2019 Ministria e Mbrojtjes ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë. Në kërkesë parashtrohet se:

- *Procedurat e ekzekutimit të detyrueshëm kanë nisur;*
- *Ministria e Mbrojtjes ka ushtruar rekurs kundër vendimit dhe çështja pritet të gjykohet në Gjykatën e Lartë;*
- *Gjykata ka gabuar në ndryshimin e bazës ligjore të padisë, nga Ligji nr. 8549/1999 duke zbatuar Ligjin nr. 152/2013;*
- *Gjykata Administrative e Apelit ka shkelur parimin e kontradiktoritetit;*
- *Ekzekutimi i detyrueshëm i titullit ekzekutiv ka nisur dhe se ka rrezik që vendimi të ekzekutohet edhe pse është marrë në kundërshtim me ligjin, pasi vlera e detyrimit është 4.128.655 Lekë;*
- *Nëse vendimi gjyqësor ekzekutohet atëhere do të rrezikohet veprimtaria e institucionit dhe nuk do munden të përmbushen shërbimet dhe detyrimet ligjore kundrejt qytetarëve;*
- *Nuk ka buxhet të planifikuar për ekzekutimin e këtij vendimi gjyqësor dhe se vendimi duhet të pezullohet, deri në shqyrtimin e rekursit nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë.*

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë

Pasi dëgjoi relatimin e gjyqtarit, z. **Sokol Sadushi**, mbi kërkesën e pezullimit të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë,

VËREN:

1. Faktet e çështjes

1. **Gjykata Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me Vendimin nr. 2095 (80-2016-2088), datë 29.04.2016** ka vendosur: “1. *Rrëzimin e kërkesë padisë si të pabazuar në ligj dhe në prova.*”.

2. **Gjykata Administrative e Apelit me Vendimin nr. 430, datë 14.02.2019** ka vendosur: “- *Ndryshimin e Vendimit nr. 2095 (80-2016-2088), datë 29.04.2016 të Gjykatës Administrative e Shkallës së Parë në këtë mënyrë: - Pranimin e padisë së paditëses Albana Spahiu. – Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ Vendimit nr. 68, datë 08.01.2014 për kalimin në listë të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mbrojtjes. – Kthimin e paditëses, Albana Spahiu, në vendin e mëparshëm të punës kthimin e saj në një pozicion pune të barazvlefshëm me të. – Detyrimin e palës së paditur, Ministria e Mbrojtjes, t’i paguajë paditëses, Albana Spahiu, pagën nga data e kalimit në listë pritje deri në datën e kthimit në detyrë.*”.

3. Kundër Vendimit nr. 430, datë 14.02.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit ka ushtruar rekurs pala e paditur, Ministria e Mbrojtjes. Në rekurs është kërkuar prishja e vendimit të gjykatës së apelit dhe rrëzimin e padisë si të pabazuar në ligj.

4. **Me datë 07.05.2019 Ministria e Mbrojtjes ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë. Në kërkesë parashtrohet se:**

- *Procedurat e ekzekutimit të detyrueshëm kanë nisur;*
- *Ministria e Mbrojtjes ka ushtruar rekurs kundër vendimit dhe çështja pritet të gjykohet në Gjykatën e Lartë;*
- *Gjykata ka gabuar në ndryshimin e bazës ligjore të padisë, nga Ligji nr. 8549/1999 duke zbatuar Ligjin nr. 152/2013;*
- *Gjykata Administrative e Apelit ka shkelur parimin e kontradiktoritetit;*
- *Ekzekutimi i detyrueshëm i titullit ekzekutiv ka nisur dhe se ka rrezik që vendimi të ekzekutohet edhe pse është marrë në kundërshtim me ligjin, pasi vlera e detyrimit është 4.128.655 Lekë;*
- *Nëse vendimi gjyqësor ekzekutohet atëhere do të rrezikohet veprimtaria e institucionit dhe nuk do munden të përmbushen shërbimet dhe detyrimet ligjore kundrejt qytetarëve;*
- *Nuk ka buxhet të planifikuar për ekzekutimin e këtij vendimi gjyqësor dhe se vendimi duhet të pezullohet, deri në shqyrtimin e rekursit nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë.*

5. Rezulton se përmbaruesi gjyqësor ka realizuar njoftimin e debitorit për ekzekutimin vullnetar e më tej ka nisur ekzekutimi i detyrueshëm. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur të procedojë me njoftimin e palëve për kërkesën e palës së paditur për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë.

2. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

6. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

7. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

8. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:

a) *ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme; dhe/ose*

b) *pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.*

9. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të riparueshëm dhe të atëçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;
- (nuk) cenohet rëndë interesi publik.

10. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të inicuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

11. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentat e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim.

12. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim. Nga ana tjetër abuzimi me mjetin ligjor të parashikuar nga neni 479 i Kodit të Procedurës Civile mund të shkaktojë dhe aktivizimin e përgjegjësive personale pasurore të palës apo përfaqësuesit, sipas pikës 1 të nenit 34 të Kodit.

13. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në funksion të zgjidhjes së çështjes konkrete, vlerëson se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë e paraqitur nga pala e paditur, Ministria e Mbrojtjes, është e pabazuar në ligj dhe si e tillë nuk duhet të pranohet. Gjykata e Lartë konstaton se shkaqet e rekursit ngrenë çështje të zbatimit të ligjit të cilat janë të zgjidhura tashmë nga jurisprudenca dhe praktika gjyqësore e konsoliduar e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë. Nga ana tjetër Ministria e Mbrojtjes nuk ka paraqitur argumentet dhe provat konkrete për vërtetimin e dëmit të riparueshëm dhe të atëçastshëm që palës debitore mund t'i vijë nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Për rrjedhojë Kolegji vlerëson se kërkesa nuk bazohet në nenin 479 të Kodit të Procedurës Civile dhe si e tillë nuk duhet të pranohet.

PËR KËTO ARSYE:

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, mbështetur në Nenin 479 të Kodit të Procedurës Civile,

VENDOSI:

Mospranimin e kërkesës për pezullim të Ministrisë së Mbrojtjes kundër Vendimit nr. 2095, datë 29.04.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, të ndryshuar me Vendimin nr. 430, datë 14.02.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit.

Tiranë, me datë 04.05.2020

ANËTAR

ILIR PANDA

ANËTAR

ERVIN PUPE

KRYESUES

SOKOL SADUSHI



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

Nr. 129/473 Regjistri.

VENDIM

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

**SOKOL SADUSHI
ERVIN PUPE
ILIR PANDA**

**KRYESUES
ANËTAR
ANËTAR**

Sot më datë 04.05.2020, mori në shqyrtim në dhomë këshillimi kërkesën Nr. 473 Prot., datë 21.10.2019, si më poshtë:

KËRKUES: AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

PADITËS: Z. ARJAN VASIJA

I PADITUR: AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

OBJEKTI: Pezullimin e ekzekutimit të Vendimit nr. 2146, datë 04.07.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit.

BAZA LIGJORE: Neni 479 i Kodit të Procedurës Civile.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër me Vendimin Nr. 529, datë 12.07.2016 ka vendosur ndër të tjera: *“Pranimin e pjesshëm të kërkesëpadisë në këtë mënyrë. Të konstatojë zgjidhjen e kontratës së punës së lidhur midis palës paditëse, Arjan Vasija, e palës së paditur, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Shkodër, si zgjidhje me efekt të menjëhershëm dhe të pajustificuar. Detyrimin e palës së paditur, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Shkodër, për t’i dhënë palës paditëse, Arjan Vasija, pagë e shpërblim për dëmin si më poshtë: 1. Pagën që do të kishte fituar nëse marrëdhënia e punës do të përfundonte në fund të afatit të njoftimit për afatin legjitim një mujor. 2. Një dëmshpërblim prej 2 paga mujore për mosrespektimin e procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës dhe, 3. Një dëmshpërblim prej 8 pagash mujore për zgjidhjen e menjëhershme e të pajustificuar të kontratës së punës. Rrëzimin e kërkesëpadisë në çështjen administrative nr. 1579/457 akti, datë 16./ 20.10.2015 që është ngritur nga pala paditëse Arjan Vasija për pjesët e tjera si e pabazuar në ligj dhe në prova.”.*

Gjykata Administrative e Apelit me Vendimin nr. 2146, datë 04.07.2019 ka vendosur: *“- Lënien në fuqi të Vendimit nr. 529, datë 12.07.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër.”.*

Kundër Vendimit nr. 2146, datë 04.07.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit ka ushtruar rekurs Agjencia Shtetërore e Kadastrës. Në rekurs është kërkuar ndryshimi i vendimeve të gjykatave të faktit dhe rrëzimin e padisë.

Me datë 21.10.2019 Agjencia Shtetërore e Kadastrës ka kërkuar pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë. Në kërkesë parashtrohet se:

- *Vendimi i gjykatës së apelit dhe vendimi i gjykatës së shkallës së parë është marrë në zbatim të gabuar të ligjit material dhe në kundërshtim me provat që janë administruar gjatë gjykimit, pasi padia duhet të ishte rrëzuar;*
- *Ekzekutimi i vendimit të gjykatës së apelit mundet të sjellë dëme të pariparueshme për palën e paditur, pasi kemi të bëjmë me një shumë të konsiderueshme për buxhetin e shtetit;*
- *Në rast ekzekutimi do të ishte i pamundur kthimi i shumave;*
- *Vendimi gjyqësor i formës së prerë duhet të pezullohet, deri në shqyrtimin e rekursit nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë.*

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoji relatimin e gjyqtarit, z. **Sokol Sadushi**, mbi kërkesën e pezullimit të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë,

VËREN:

1. FAKTET E ÇËSHTJES

1. **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër me Vendimin Nr. 529, datë 12.07.2016** ka vendosur ndër të tjera: *“Pranimin e pjesshëm të kërkesëpadisë në këtë mënyrë. Të konstatojë zgjidhjen e kontratës së punës së lidhur midis palës paditëse, Arjan Vasija, e palës së paditur, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Shkodër, si zgjidhje me efekt të menjëhershëm dhe të pajustificuar. Detyrimin e palës së paditur, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Shkodër, për t’i dhënë palës paditëse, Arjan Vasija, pagë e shpërblim për dëmin si më poshtë: 1. Pagën që do të kishte fituar nëse marrëdhënia e punës do të përfundonte në fund të afatit të njoftimit për afatin legjitim një mujor. 2. Një dëmshpërblim prej 2 paga mujore për mosrespektimin e procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës dhe, 3. Një dëmshpërblim prej 8 pagash mujore për zgjidhjen e menjëhershme e të pajustificuar të kontratës së punës. Rrëzimin e kërkesëpadisë në çështjen administrative nr. 1579/457 akti, datë 16./ 20.10.2015 që është ngritur nga pala paditëse Arjan Vasija për pjesët e tjera si e pabazuar në ligj dhe në prova.”.*

2. **Gjykata Administrative e Apelit me Vendimin nr. 2146, datë 04.07.2019** ka vendosur: *“- Lënien në fuqi të Vendimit nr. 529, datë 12.07.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër.”.*

3. Kundër Vendimit nr. 2146, datë 04.07.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit ka ushtruar rekurs Agjencia Shtetërore e Kadastrës. Në rekurs është kërkuar ndryshimi i vendimeve të gjykatave të faktit dhe rrëzimin e padisë.

4. Me datë 21.10.2019 Agjencia Shtetërore e Kadastrës ka kërkuar pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë. Në kërkesë parashtrohet se:

- *Vendimi i gjykatës së apelit dhe vendimi i gjykatës së shkallës së parë është marrë në zbatim të gabuar të ligjit material dhe në kundërshtim me provat që janë administruar gjatë gjykimit, pasi padia duhet të ishte rrëzuar;*

- *Ekzekutimi i vendimit të gjykatës së apelit mundet të sjellë dëme të pariparueshme për palën e paditur, pasi kemi të bëjmë me një shumë të konsiderueshme për buxhetin e shtetit;*
- *Në rast ekzekutimi do të ishte i pamundur kthimi i shumave;*
- *Vendimi gjyqësor i formës së prerë duhet të pezullohet, deri në shqyrtimin e rekursit nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë.*

2. VLERËSIMI I KOLEGJIT ADMINISTRATIV TË GJYKATËS SË LARTË

5. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

6. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atëçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

7. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndër gjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:

a) *ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme; dhe/ose*

b) *pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin e vendimit.”.*

8. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të pariparueshëm dhe të atëçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;
- (nuk) cenohet rëndë interesi publik.

9. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të inicuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

10. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentat e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim.

11. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim. Nga ana tjetër abuzimi me mjetin ligjor të parashikuar nga neni 479 i Kodit të Procedurës Civile mund të shkaktojë dhe aktivizimin e përgjegjësisë personale pasurore të palës apo përfaqësuesit, sipas pikës 1 të nenit 34 të Kodit.

12. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë është e pabazuar në ligj dhe si e tillë nuk duhet të pranohet. Gjykata e Lartë konstaton se shkaqet e rekursit janë paraqitur si shkaqe të kërkesës për pezullimin e vendimit të formës së prerë dhe për rrjedhojë kërkesa për pezullim nuk paraqet shkaqe të përligjura dhe që mundet të shqyrtohen në këtë gjykim të posaçëm të masave të përkohshme procedurale. Nga ana tjetër pala kërkuese nuk ka paraqitur argumentet dhe provat konkrete për vërtetimin e dëmit të riparueshëm dhe të atëçastshëm që palës debitore mund t'i vijë nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Për rrjedhojë Kolegji konkludon se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë nuk mund të pranohet, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile.

PËR KËTO ARSYE:

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë mbështetur në Nenin 299 shkronja "c" të Kodit të Procedurës Civile,

VENDOSI:

Mospranimin e kërkesës për pezullim të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës kundër Vendimit nr. 529, datë 12.07.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër të ndryshuar me Vendimin nr. 2146, datë 04.07.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit.

Tiranë, me datë 04.05.2020

ANËTAR

ILIR PANDA

ANËTAR

ERVIN PUPE

KRYESUES

SOKOL SADUSHI



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

Nr. 96/425 Regjistri.

VENDIM

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

**SOKOL SADUSHI
ERVIN PUPE
ILIR PANDA**

**KRYESUES
ANËTAR
ANËTAR**

Sot më datë 04.05.2020, mori në shqyrtim në dhomë këshillimi kërkesën Nr. 2299 Prot., datë 19.09.2019, si më poshtë:

KËRKUES: **BASHKIA TIRANËS**

PADITËS: **Z. BESNIK BICI**

I PADITUR: **BASHKIA TIRANË**

OBJEKTI: Pezullimi i zbatimit të Vendimit nr. 5361 (3622), datë 26.10.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, që është lënë në fuqi me Vendimin nr. 36, datë 18.01.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit.

BAZA LIGJORE: Neni 479 i Kodit të Procedurës Civile.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me Vendimin Nr. 5361, datë 26.10.2015 ka vendosur ndër të tjera: *“Pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë. Detyrimin e palës së paditur, Bashkia Tiranë, t’i paguajë paditësit, Besnik Bici, dëmshpërblim me 7 (shtatë) muaj pagë, për zgjidhje të menjëhershme dhe të pajustificuar të kontratës së punës, si dhe 3 muaj paga mujore për mosrespektim të afateve të njoftimit për zgjidhjen e kontratës. Detyrimin e palës së paditur, Bashkia Tiranë, t’i paguajë paditësit, Besnik Bici, si dëmshpërblim pagën e 2 muajve punë për shkak të mosrespektimit të procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës. Detyrimin e palës së paditur, Bashkia Tiranë, t’i paguajë paditësit, Besnik Bici, shpërblim për vjetërsi në punë në masën e 4 pagave mujore. Rrëzimin e kërkesëpadisë për kërkimet e tjera, si të pabazuara në ligj.”.*

Gjykata Administrative e Apelit me Vendimin nr. 36, datë 18.01.2019 ka vendosur: *“Lënien në fuqi të Vendimit nr. 5361, datë 26.10.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.”.*

Kundër Vendimit nr. 36, datë 18.01.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit ka ushtruar rekurs pala e paditur, Bashkia Tiranë. Në rekurs është kërkuar ndryshimi i vendimeve të të dy gjykatave të faktit dhe rrëzimi i padisë si e pabazuar në ligj.

Me datë 19.09.2019 Bashkia Tiranë ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë. Në kërkesë parashtrohet se:

- *Bashkia Tiranë ka ushtruar rekurs kundër vendimit dhe çështja pritet të gjykohet në Gjykatën e Lartë;*
- *Ekzekutimi i detyrueshëm i titullit ekzekutiv ka nisur dhe se ka rrezik që vendimi të ekzekutohet edhe pse është marrë në kundërshtim me ligjin;*
- *Pozicioni i punës që pala paditëse ka pasur është shkrirë dhe se në këto kushte marrëdhënia e punës është ndërprerë dhe për rrjedhojë shkaqet kanë qenë të justifikuara;*
- *Nëse vendimi gjyqësor ekzekutohet atëhere do të rrezikohet veprimtaria e institucionit dhe nuk do munden të përmbushen shërbimet dhe detyrimet ligjore kundrejt qytetarëve;*
- *Nuk ka buxhet të planifikuar për ekzekutimin e këtij vendimi gjyqësor dhe se vendimi duhet të pezullohet, deri në shqyrtimin e rekursit nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë.*

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoi relatimin e gjyqtarit, z. **Sokol Sadushi**, mbi kërkesën e pezullimit të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë,

VËREN:

1. FAKTET E ÇËSHTJES

1. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me Vendimin Nr. 5361, datë 26.10.2015 ka vendosur ndër të tjera: *“Pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë. Detyrimin e palës së paditur, Bashkia Tiranë, t’i paguajë paditësit, Besnik Bici, dëmshpërblim me 7 (shtatë) muaj pagë, për zgjidhje të menjëhershme dhe të pajustificuar të kontratës së punës, si dhe 3 muaj paga mujore për mosrespektim të afateve të njoftimit për zgjidhjen e kontratës. Detyrimin e palës së paditur, Bashkia Tiranë, t’i paguajë paditësit, Besnik Bici, si dëmshpërblim pagën e 2 muajve punë për shkak të mosrespektimit të procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës. Detyrimin e palës së paditur, Bashkia Tiranë, t’i paguajë paditësit, Besnik Bici, shpërblim për vjetërsi në punë në masën e 4 pagave mujore. Rrëzimin e kërkesëpadisë për kërkimet e tjera, si të pabazuara në ligj.”.*

2. Gjykata Administrative e Apelit me Vendimin nr. 36, datë 18.01.2019 ka vendosur: *“Lënien në fuqi të Vendimit nr. 5361, datë 26.10.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.”.*

3. Kundër Vendimit nr. 36, datë 18.01.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit ka ushtruar rekurs pala e paditur, Bashkia Tiranë. Në rekurs është kërkuar ndryshimi i vendimeve të të dy gjykatave të faktit dhe rrëzimi i padisë si e pabazuar në ligj.

4. Me datë 19.09.2019 Bashkia Tiranë ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë. Në kërkesë parashtrohet se:

- *Bashkia Tiranë ka ushtruar rekurs kundër vendimit dhe çështja pritet të gjykohet në Gjykatën e Lartë;*
- *Ekzekutimi i detyrueshëm i titullit ekzekutiv ka nisur dhe se ka rrezik që vendimi të ekzekutohet edhe pse është marrë në kundërshtim me ligjin;*
- *Pozicioni i punës që pala paditëse ka pasur është shkrirë dhe se në këto kushte marrëdhënia e punës është ndërprerë dhe për rrjedhojë shkaqet kanë qenë të justifikuara;*

- Nëse vendimi gjyqësor ekzekutohet atëhere do të rrezikohet veprimtaria e institucionit dhe nuk do mundën të përmbushen shërbimet dhe detyrimet ligjore kundrejt qytetarëve;
- Nuk ka buxhet të planifikuar për ekzekutimin e këtij vendimi gjyqësor dhe se vendimi duhet të pezullohet, deri në shqyrtimin e rekursit nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë.

5. Rezulton se përmbaruesi gjyqësor ka realizuar njoftimin e debitorit për ekzekutimin vullnetar e më tej ka nisur ekzekutimi i detyrueshëm. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur të procedojë me njoftimin e palëve për kërkesën e palës së paditur për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë.

2. VLERËSIMI I KOLEGJIT ADMINISTRATIV TË GJYKATËS SË LARTË

6. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

7. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atëçastshëm dhe eminent për shkakimin e një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

8. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:

a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme; dhe/ose

b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin e vendimit.”.

9. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të pariparueshëm dhe të atëçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;
- (nuk) cenohet rëndë interesi publik.

10. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për

pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të inicuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

11. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentat e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim.

12. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim. Nga ana tjetër abuzimi me mjetin ligjor të parashikuar nga neni 479 i Kodit të Procedurës Civile mund të shkaktojë dhe aktivizimin e përgjegjësive personale pasurore të palës apo përfaqësuesit, sipas pikës 1 të nenit 34 të Kodit.

13. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë është e pabazuar në ligj dhe si e tillë nuk duhet të pranohet. Gjykata e Lartë konstaton se shkaqet e rekursit janë paraqitur si shkaqe të kërkesës për pezullimin e vendimit të formës së prerë dhe për rrjedhojë kërkesa për pezullim nuk paraqet shkaqe të përligjura dhe që mundet të shqyrtohen në këtë gjykim të posaçëm të masave të përkohshme procedurale. Nga ana tjetër pala kërkuese nuk ka paraqitur argumentet dhe provat konkrete për vërtetimin e dëmit të riparueshëm dhe të atëçastshëm që palës debitore mund t'i vijë nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Për rrjedhojë Kolegji konkludon se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë nuk mund të pranohet, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile.

PËR KËTO ARSYE:

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë mbështetur në Nenin 479 të Kodit të Procedurës Civile,

VENDOSI:

Mospranimin e kërkesës së Bashkisë Tiranë për pezullimin e ekzekutimit të Vendimit nr. 5361 (3622), datë 26.10.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, që është lënë në fuqi me Vendimin nr. 36, datë 18.01.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit.

Tiranë, me datë 04.05.2020

ANËTAR

ILIR PANDA

ANËTAR

ERVIN PUPE

KRYESUES

SOKOL SADUSHI



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

Nr. 143/502 Regjistri.

VENDIM

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

**SOKOL SADUSHI
ERVIN PUPE
ILIR PANDA**

**KRYESUES
ANËTAR
ANËTAR**

Sot më datë 04.05.2020, mori në shqyrtim në dhomë këshillimi kërkesën Nr. 502 Regj., datë 21.11.2019, si më poshtë:

KËRKUES: **AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS**

PADITËS: **Z. DEVIS QANA**

I PADITUR **AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS
DREJTORIA VENDORE Durrës E AGJENCISË
SHTETËRORE TË KADASTRËS**

OBJEKTI: Pezullimin e ekzekutimit të Vendimit nr. 1334 (86-2019-1519), datë 02.05.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit.

BAZA LIGJORE: Neni 479 i Kodit të Procedurës Civile.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës me Vendimin nr. 7 (82-2016-11), date 12.01.2016 ka vendosur ka vendosur: “- *Pranimin e pjesshëm të kërkesëpadisë. – Detyrimin e palëve të paditura të dëmshpërblejnë paditësin, Devis Qana me 3 muaj pagë për shkak të zgjidhjes së menjëhershme të kontratës së punës pa shkaqe të justifikuara, sipas nenit 155 të Kodit të Punës. – Detyrimin e palëve të paditura të dëmshpërblejnë paditësin me 2 muaj pagë sipas nenit 143 të Kodit të Punës. – Detyrimin e palëve të paditura të dëmshpërblejnë paditësin me 2 muaj pagë sipas nenit 144 të Kodit të Punës. – Detyrimin e palëve të paditura të dëmshpërblejnë paditësin me pagën e një pesëmbëdhjetëditëshi mbi çdo vit pune të plotë (paga mujore në përfundim të marrëdhënieve të punës) për periudhën 21.06.2012 – 21.06.2015, në kuptim të nenit 145 të Kodit të Punës. – Rrëzimin për pjesën tjetër. – Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.”.*

Gjykata Administrative e Apelit me Vendimin nr. 1334 (86-2019-1519), datë 02.05.2019 ka vendosur: “*Lënie në fuqi të Vendimit nr. 7, datë 12.01.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës.*”.

Pala e paditur, Agjencia Shtetërore e Kadastrës ka ushtruar rekurs kundër vendimit të gjykatës së apelit, duke parashtruar edhe shkaqet respektive të kundërshtimit ligjor dhe duke kërkuar ndryshimin e të dy vendimeve dhe rrëzimin e padisë si të pabazuar në ligj dhe në prova.

Me datë 21.11.2019 pala e paditur, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë. Në kërkesë parashtrohet se:

- *Ndaj vendimit të gjykatës së apelit është ushtruar rekurs dhe pritet të vendosë Gjykata e Lartë;*
- *Ekziston domosdoshmëria e marrjes së masës së pezullimit, pasi ka urgjencë dhe sengarkimi i palës së paditur me këtë detyrim financiar do të rrezikonte funksionimin e institucionit;*
- *Vendimi duhet të pezullohet, deri në shqyrtimin e rekursit nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë.*

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoji relatimin e gjyqtarit, z. **Sokol Sadushi**, mbi kërkesën e pezullimit të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë,

VËREN:

1. FAKTET E ÇËSHTJES

1. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës me Vendimin nr. 7 (82-2016-11), date 12.01.2016 ka vendosur ka vendosur: “- *Pranimin e pjesshëm të kërkesëpadisë. – Detyrimin e palëve të paditura të dëmshpërblejnë paditësin, Devis Qana me 3 muaj pagë për shkak të zgjidhjes së menjëhershme të kontratës së punës pa shkaqe të justifikuara, sipas nenit 155 të Kodit të Punës. – Detyrimin e palëve të paditura të dëmshpërblejnë paditësin me 2 muaj pagë sipas nenit 143 të Kodit të Punës. – Detyrimin e palëve të paditura të dëmshpërblejnë paditësin me 2 muaj pagë sipas nenit 144 të Kodit të Punës. – Detyrimin e palëve të paditura të dëmshpërblejnë paditësin me pagën e një pesëmbëdhjetëditëshi mbi çdo vit pune të plotë (paga mujore në përfundim të marrëdhënieve të punës) për periudhën 21.06.2012 – 21.06.2015, në kuptim të nenit 145 të Kodit të Punës. – Rrëzimin për pjesën tjetër. – Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.”.*

2. Gjykata Administrative e Apelit me Vendimin nr. 1334 (86-2019-1519), datë 02.05.2019 ka vendosur: “*Lënien në fuqi të Vendimit nr. 7, datë 12.01.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës.*”.

3. Pala e paditur, Agjencia Shtetërore e Kadastrës ka ushtruar rekurs kundër vendimit të gjykatës së apelit, duke parashtruar edhe shkaqet respektive të kundërshtimit ligjor dhe duke kërkuar ndryshimin e të dy vendimeve dhe rrëzimin e padisë si të pabazuar në ligj dhe në prova.

4. Me datë 21.11.2019 pala e paditur, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë. Në kërkesë parashtrohet se:

- *Ndaj vendimit të gjykatës së apelit është ushtruar rekurs dhe pritet të vendosë Gjykata e Lartë;*

- *Ekziston domosdoshmëria e marrjes së masës së pezullimit, pasi ka urgjencë dhe sengarkimi i palës së paditur me këtë detyrim financiar do të rrezikonte funksionimin e institucionit;*
- *Vendimi duhet të pezullohet, deri në shqyrtimin e rekursit nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë.*

2. VLERËSIMI I KOLEGJIT ADMINISTRATIV TË GJYKATËS SË LARTË

6. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

7. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atçastshëm dhe eminent për shkakimin e një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

8. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:

a) *ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme; dhe/ose*

b) *pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.*

9. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të pariparueshëm dhe të atçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;
- (nuk) cenohet rëndë interesi publik.

10. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të inicuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

11. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentat e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim.

12. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim. Nga ana tjetër abuzimi me mjetin ligjor të parashikuar nga neni 479 i Kodit të Procedurës Civile mund të shkaktojë dhe aktivizimin e përgjegjësisë personale pasurore të palës apo përfaqësuesit, sipas pikës 1 të nenit 34 të Kodit.

13. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë është e pabazuar në ligj dhe si e tillë nuk duhet të pranohet. Gjykata e Lartë konstaton se shkaqet e rekursit janë paraqitur si shkaqe të kërkesës për pezullimin e vendimit të formës së prerë dhe për rrjedhojë kërkesa për pezullim nuk paraqet shkaqe të përligjura dhe që mundet të shqyrtohen në këtë gjykim të posaçëm të masave të përkohshme procedurale. Nga ana tjetër pala kërkuese nuk ka paraqitur argumentet dhe provat konkrete për vërtetimin e dëmit të riparueshëm dhe të atëçastshëm që palës debitore mund t'i vijë nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Për rrjedhojë Kolegji konkludon se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë nuk mund të pranohet, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile.

PËR KËTO ARSYE:

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë mbështetur në Nenin 479 të Kodit të Procedurës Civile,

VENDOSI:

Mospranimin e kërkesës së palës së paditur, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, për pezullimin e ekzekutimit të Vendimit nr. 1334 (86-2019-1519), datë 02.05.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit.

Tiranë, me datë 04.05.2020

ANËTAR

ANËTAR

KRYESUES

ILIR PANDA

ERVIN PUPE

SOKOL SADUSHI



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

Nr. 52/338 Regjistri.

VENDIM

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

**SOKOL SADUSHI
ERVIN PUPE
ILIR PANDA**

**KRYESUES
ANËTAR
ANËTAR**

Sot më datë 04.05.2020, mori në shqyrtim në dhomë këshillimi kërkesën Nr. 338 Prot., datë 24.06.2019, si më poshtë:

KËRKUES: **AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS**

PADITËS: **Z. ERMIR PETRITI**

I PADITUR: **DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ALUIZNI TIRANË**

OBJEKTI: Pezullim i ekzekutimit të Vendimit nr. 853, datë 19.05.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë, të lënë në fuqi me Vendimin nr. 1155, datë 18.04.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

BAZA LIGJORE: Neni 479 i Kodit të Procedurës Civile.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë me Vendimin Nr. 853, datë 19.05.2017 ka vendosur ndër të tjera: “- *Pranimin e pjesshëm të kërkesëpadisë. – Detyrimin e palës së paditur që t’i paguajë paditësit Ermir Petriti një dëmshpërblim prej 4 (katër) muaj pagë për shkak të zgjidhjes së menjëhershme e të pajustificuar të kontratës së punës. – Detyrimin e palës së paditur që t’i paguajë paditësit një shpërblim prej 1 (një) muaj pagë për mosrespektim të afatit të njoftimit për zgjidhjen e kontratës së punës. – Detyrimin e palës së paditur që t’i paguajë paditësit një dëmshpërblim prej 2 (dy) muaj pagë për mosrespektim të procedurës për zgjidhjen e kontratës së punës. – Rrëzimin e padisë për pjesën tjetër të kërkesëpadisë.*”.

Gjykata Administrative e Apelit me Vendimin nr. 1155, datë 18.04.2019 ka vendosur: “*Lënien në fuqi të Vendimit nr. 853, datë 19.01.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë.*”.

Kundër Vendimit nr. 1155, datë 18.04.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit ka ushtruar rekurs pala e paditur, Agjencia Shtetërore e Kadastrës. Në rekurs është kërkuar ndryshimi i vendimeve të dy gjykatave të faktit dhe rrëzimi i padisë si e pabazuar në ligj.

Me datë 24.06.2019 Agjencia Shtetërore e Kadastrës ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë.

Në kërkesë parashtrohet se:

- *Duke qenë se kanë nisur procedurat e ekzekutimit të detyrueshëm dhe çështja pret një zgjidhje përfundimtare, atëhere duhet që Gjykata e Lartë të pezullojë vendimin gjyqësor të formës së prerë, derisa të zgjidhet çështja;*
- *Padia është e pabazuar në ligj dhe se vendimet e gjykatave nuk kanë vlerësuar drejtë provat dhe nuk kanë zbatuar drejtë ligjin;*
- *Nëse vendimi gjyqësor ekzekutohet atëhere do të rrezikohet veprimtaria e institucionit dhe nuk do munden të përmbushen shërbimet dhe detyrimet ligjore kundrejt qytetarëve;*
- *Nuk ka buxhet të planifikuar për ekzekutimin e këtij vendimi gjyqësor dhe se vendimi duhet të pezullohet, deri në shqyrtimin e rekursit nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë.*

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoji relatimin e gjyqtarit, z. **Sokol Sadushi**, mbi kërkesën e pezullimit të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë,

VËREN:

1. Faktet e çështjes

1. **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë me Vendimin Nr. 853, datë 19.05.2017** ka vendosur ndër të tjera: “- *Pranimin e pjesshëm të kërkesëpadisë. – Detyrimin e palës së paditur që t’i paguajë paditësit Ermir Petriti një dëmshpërblim prej 4 (katër) muaj pagë për shkak të zgjidhjes së menjëhershme e të pajustificuar të kontratës së punës. – Detyrimin e palës së paditur që t’i paguajë paditësit një shpërblim prej 1 (një) muaj pagë për mosrespektim të afatit të njoftimit për zgjidhjen e kontratës së punës. – Detyrimin e palës së paditur që t’i paguajë paditësit një dëmshpërblim prej 2 (dy) muaj pagë për mosrespektim të procedurës për zgjidhjen e kontratës së punës. – Rrëzimin e padisë për pjesën tjetër të kërkesëpadisë.”.*

2. **Gjykata Administrative e Apelit me Vendimin nr. 1155, datë 18.04.2019** ka vendosur: “*Lënien në fuqi të Vendimit nr. 853, datë 19.01.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë.”.*

3. Kundër Vendimit nr. 1155, datë 18.04.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit ka ushtruar rekurs pala e paditur, Agjencia Shtetërore e Kadastrës. Në rekurs është kërkuar ndryshimi i vendimeve të dy gjykatave të faktit dhe rrëzimi i padisë si e pabazuar në ligj.

4. **Me datë 24.06.2019 Agjencia Shtetërore e Kadastrës ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë.** Në kërkesë parashtrohet se:

- *Duke qenë se kanë nisur procedurat e ekzekutimit të detyrueshëm dhe çështja pret një zgjidhje përfundimtare, atëhere duhet që Gjykata e Lartë të pezullojë vendimin gjyqësor të formës së prerë, derisa të zgjidhet çështja;*

- *Padia është e pabazuar në ligj dhe se vendimet e gjykatave nuk kanë vlerësuar drejtë provat dhe nuk kanë zbatuar drejtë ligjin;*
- *Nëse vendimi gjyqësor ekzekutohet atëherë do të rrezikohet veprimtaria e institucionit dhe nuk do mundën të përmbushen shërbimet dhe detyrimet ligjore kundrejt qytetarëve;*
- *Nuk ka buxhet të planifikuar për ekzekutimin e këtij vendimi gjyqësor dhe se vendimi duhet të pezullohet, deri në shqyrtimin e rekursit nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë.*

2. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

5. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

6. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atëçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

7. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:

a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme; dhe/ose

b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin e vendimit.”.

8. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të pariparueshëm dhe të atëçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;
- (nuk) cenohet rëndë interesi publik.

9. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për

pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të inicuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

10. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentat e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim.

11. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim. Nga ana tjetër abuzimi me mjetin ligjor të parashikuar nga neni 479 i Kodit të Procedurës Civile mund të shkaktojë dhe aktivizimin e përgjegjësive personale pasurore të palës apo përfaqësuesit, sipas pikës 1 të nenit 34 të Kodit.

12. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë është e pabazuar në ligj dhe si e tillë nuk duhet të pranohet. Gjykata e Lartë konstaton se shkaqet e rekursit janë paraqitur si shkaqe të kërkesës për pezullimin e vendimit të formës së prerë dhe për rrjedhojë kërkesa për pezullim nuk paraqet shkaqe të përligjura dhe që mundet të shqyrtohen në këtë gjykim të posaçëm të masave të përkohshme procedurale. Nga ana tjetër pala kërkuese nuk ka paraqitur argumentet dhe provat konkrete për vërtetimin e dëmit të riparueshëm dhe të atëçastshëm që palës debitorë mund t'i vijë nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Për rrjedhojë Kolegji konkludon se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë nuk mund të pranohet, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile.

PËR KËTO ARSYE:

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë mbështetur në Nenin 479 të Kodit të Procedurës Civile,

VENDOSI:

Mospranimin e kërkesës për pezullim të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës kundër Vendimit Nr. 853, datë 19.05.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me Vendimin nr. 1155, datë 18.04.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit.

Tiranë, me datë 04.05.2020

ANËTAR

ANËTAR

KRYESUES

ILIR PANDA

ERVIN PUPE

SOKOL SADUSHI



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

Nr. 29/301 Regjistri.

VENDIM

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

**SOKOL SADUSHI
ERVIN PUPE
ILIR PANDA**

**KRYESUES
ANËTAR
ANËTAR**

Sot më datë 04.05.2020, mori në shqyrtim në dhomë këshillimi kërkesën Nr. 1545 Prot., datë 22.05.2019, si më poshtë:

KËRKUES: NDËRMARRJA MEICO

PADITËSE: ZNJ. SUZANA ALLA
Z. GËZIM ALLA

I PADITUR: KËSHILLI I MINISTRAVE
MINISTRIA E MBROJTJES
NDËRMARRJA MEICO
ALBADEMIL SH.P.K.

OBJEKTI: Pezullimin e ekzekutimit të Vendimit nr. 4227, datë 23.07.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me Vendimin nr. 988, datë 28.03.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit.

BAZA LIGJORE: Neni 479 dhe 615 të Kodit të Procedurës Civile.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me Vendimin Nr. 4227, datë 23.07.2015 ka vendosur ndër të tjera: “- *Pranimin e kërkesë padisë së paraqitur nga paditësat Suzana Alla, Gëzim Alla. – Detyrimin e palëve të paditura, Këshilli i Ministrave, Ministria e Mbrojtjes, shoqëria Albademil sh.p.k. dhe Ndërmarrja MEICO, që të dëmshpërblejnë në mënyrë solidare paditësin Gëzim Alla, për dëmin jopasuror në shumën 7.522.182 Lekë. – Detyrimin e palëve të paditura, Këshilli i Ministrave, Ministria e Mbrojtjes, shoqëria Albademil sh.p.k. dhe Ndërmarrja MEICO, që të dëmshpërblejnë në mënyrë solidare paditësen Suzana Alla, për dëmin jopasuror në shumën 7.522.182 Lekë.*”.

Gjykata Administrative e Apelit me Vendimin nr. 988, datë 28.03.2019 ka vendosur: “Lënien në fuqi të Vendimit nr. 4227, datë 23.07.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë.”.

Kundër Vendimit nr. 988, datë 28.03.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit ka ushtruar rekurs pala e paditur, Ndërmarrja MEICO. Në rekurs është kërkuar ndryshimi i vendimeve të të dy gjykatave të faktit dhe rrëzimi i padisë si e pabazuar në ligj.

Me datë 22.05.2019 Ndërmarrja MEICO ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë. Në kërkesë parashtrohet se:

- *Vendimi penal i formës së prerë ka vendosur se përgjegjësi ka pasur shoqëria Albademil sh.p.k. dhe shoqëria amerikane SAC, që me kontratë kanë marrë përsipër ushtrimin e aktivitetit në siguri maksimale;*
- *Ndërmarrja MEICO nuk mundet të mbajë përgjegjësi pse ka shitur mallin ushtarak për llogari të Ministrisë së Mbrojtjes tek shoqëritë demontuese;*
- *Përgjegjësia e MEICO mbaron kur lidhet kontrata e shitjes dhe dorëzohet malli i blerë dhe ka kryer të gjitha veprimet sipas objektit të veprimtarisë së saj duke respektuar ligjin;*
- *Gjykata në kundërshtim me ligjin nuk ka marrë parasysh prapsimin e parashkrimit shues të padisë, sipas nenit 112, 115, 117, 120 të Kodit Civil;*
- *Akti i ekspertimit ka të meta dhe nuk është i bazuar në prova;*
- *Ekzekutimi i vendimit titull ekzekutiv ka nisur dhe vlera e përgjithshme e detyrimeve që ai përfaqëson është shumë e madhe dhe se aktualisht ndërmarrja nuk ka mundësi të shlyejë detyrimin;*
- *Ekzekutimi i vendimit do të shkaktonte dëme të pakthyeshme për shoqërinë, pasi ndërmarrja është organizuar me vetëfinancim dhe nuk mbulohet nga buxheti i shtetit.*
- *Duke qenë se kanë nisur procedurat e ekzekutimit të detyrueshëm dhe çështja pret një zgjidhje përfundimtare, atëhere duhet që Gjykata e Lartë të pezullojë vendimin gjyqësor të formës së prerë, derisa të zgjidhet çështja.*

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoji relatimin e gjyqtarit, z. **Sokol Sadushi**, mbi kërkesën e pezullimit të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë,

VËREN:

1. FAKTET E ÇËSHTJES

1. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me Vendimin Nr. 4227, datë 23.07.2015 ka vendosur ndër të tjera: “- *Pranimin e kërkesë padisë së paraqitur nga paditësat Suzana Alla, Gëzim Alla. – Detyrimin e palëve të paditura, Këshilli i Ministrave, Ministria e Mbrojtjes, shoqëria Albademil sh.p.k. dhe Ndërmarrja MEICO, që të dëmshpërblejnë në mënyrë solidare paditësin Gëzim Alla, për dëmin jopasuror në shumën 7.522.182 Lekë. – Detyrimin e palëve të paditura, Këshilli i Ministrave, Ministria e Mbrojtjes, shoqëria Albademil sh.p.k. dhe Ndërmarrja MEICO, që të dëmshpërblejnë në mënyrë solidare paditësen Suzana Alla, për dëmin jopasuror në shumën 7.522.182 Lekë.”.*

2. **Gjykata Administrative e Apelit me Vendimin nr. 988, datë 28.03.2019** ka vendosur: “Lënien në fuqi të Vendimit nr. 4227, datë 23.07.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë.”.

3. Kundër Vendimit nr. 988, datë 28.03.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit ka ushtruar rekurs pala e paditur, Ndërmarrja MEICO. Në rekurs është kërkuar ndryshimi i vendimeve të të dy gjykatave të faktit dhe rrezimi i padisë si e pabazuar në ligj.

4. **Me datë 22.05.2019 Ndërmarrja MEICO ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë.** Në kërkesë parashtrohet se:

- *Vendimi penal i formës së prerë ka vendosur se përgjegjësi ka pasur shoqëria Albademil sh.p.k. dhe shoqëria amerikane SAC, që me kontratë kanë marrë përsipër ushtrimin e aktivitetit në siguri maksimale;*
- *Ndërmarrja MEICO nuk mundet të mbajë përgjegjësi pse ka shitur mallin ushtarak për llogari të Ministrisë së Mbrojtjes tek shoqëritë demontuese;*
- *Përgjegjësia e MEICO mbaron kur lidhet kontrata e shitjes dhe dorëzohet malli i blerë dhe ka kryer të gjitha veprimet sipas objektit të veprimtarisë së saj duke respektuar ligjin;*
- *Gjykata në kundërshtim me ligjin nuk ka marrë parasysh prapsimin e parashkrimit shues të padisë, sipas nenit 112, 115, 117, 120 të Kodit Civil;*
- *Akti i ekspertimit ka të meta dhe nuk është i bazuar në prova;*
- *Ekzekutimi i vendimit titull ekzekutiv ka nisur dhe vlera e përgjithshme e detyrimeve që ai përfaqëson është shumë e madhe dhe se aktualisht ndërmarrja nuk ka mundësi të shlyejë detyrimin;*
- *Ekzekutimi i vendimit do të shkaktonte dëme të pakthyeshme për shoqërinë, pasi ndërmarrja është organizuar me vetëfinancim dhe nuk mbulohet nga buxheti i shtetit;*
- *Duke qenë se kanë nisur procedurat e ekzekutimit të detyrueshëm dhe çështja pret një zgjidhje përfundimtare, atëhere duhet që Gjykata e Lartë të pezullojë vendimin gjyqësor të formës së prerë, derisa të zgjidhet çështja.*

2. VLERËSIMI I KOLEGJIT ADMINISTRATIV TË GJYKATËS SË LARTË

5. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

6. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të riparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

7. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:

a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme; dhe/ose

b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.

8. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të pariparueshëm dhe të atëçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;
- (nuk) cenohet rëndë interesi publik.

9. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të inicuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

10. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentat e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim.

11. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim. Nga ana tjetër abuzimi me mjetin ligjor të parashikuar nga neni 479 i Kodit të Procedurës Civile mund të shkaktojë dhe aktivizimin e përgjegjësive personale pasurore të palës apo përfaqësuesit, sipas pikës 1 të nenit 34 të Kodit.

12. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë është e pabazuar në ligj dhe si e tillë nuk duhet të pranohet. Gjykata e Lartë konstaton se shkaqet e rekursit janë paraqitur si shkaqe të kërkesës për pezullimin e vendimit të formës së prerë dhe për rrjedhojë kërkesa për pezullim nuk paraqet shkaqe të përligjura dhe që mundet të shqyrtohen në këtë gjykim të posaçëm të masave të përkohshme procedurale. Nga ana tjetër pala kërkuese nuk ka paraqitur argumentet dhe provat konkrete për vërtetimin e dëmit të pariparueshëm dhe të atëçastshëm që palës debitore mund t'i vijë nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Për rrjedhojë Kolegji konkludon se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë nuk mund të pranohet, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile.

Për këto arsye:

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë mbështetur në Nenin 479 të Kodit të Procedurës Civile,

Vendosi:

Mospranimin e kërkesës së ndërmarrjes MEICO për pezullimin e ekzekutimit të Vendimit Nr. 4227, datë 23.07.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me Vendimin nr. 988, datë 28.03.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit.

Tiranë, me datë 04.05.2020

ANËTAR

ILIR PANDA

ANËTAR

ERVIN PUPE

KRYESUES

SOKOL SADUSHI



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

Nr. 18/279 Regjistri.

VENDIM

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

**SOKOL SADUSHI
ERVIN PUPE
ILIR PANDA**

**KRYESUES
ANËTAR
ANËTAR**

Sot më datë 04.05.2020, mori në shqyrtim në dhomë këshillimi kërkesën Nr. 279 Prot., datë 10.05.2019, si më poshtë:

KËRKUES: **MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRBARIMIT**

PADITËS: **Z. GULIT HASANAJ**

I PADITUR: **MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT**

OBJEKTI: Pezullimin e ekzekutimit deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor.

BAZA LIGJORE: Neni 479 i Kodit të Procedurës Civile.

Gjykata Administrative të Shkallës së Parë Shkodër me Vendimin nr. 717, datë 22.09.2015 ka vendosur: “- *Pranimin e kërkesë padisë në këtë mënyrë: - Të konstatojë zgjidhjen e kontratës së punës së lidhur midis palës paditëse Gulit Hasanaj, palës së paditur, Zyra Vendore e Përmbarimit Shkodër, si zgjidhje me efekt të menjëhershëm e të pajustificuar. - Detyrimin e palës së paditur, Zyra Vendore e Përmbarimit Shkodër, për t’i dhënë palës paditëse, Gulit Hasanaj, pagë e shpërblim për dëmin si më poshtë: - 1. Pagën që do të kishte fituar nëse marrëdhënia e punës do të përfundonte në fund të afatit të njoftimit, për afatin legjitim 2 mujor. 2. Një dëmshpërblim prej 2 paga mujore për mosrespektim të procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës. 3. Një dëmshpërblim prej 6 muajsh pagë për zgjidhjen e menjëhershme e të pajustificuar të kontratës së punës.”.*

Gjykata Administrative e Apelit me Vendimin nr. 4684, datë 21.12.2018 ka vendosur: “- *Lënien në fuqi të Vendimit nr. 717, datë 22.09.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.”.*

Kundër Vendimit nr. 4684, datë 21.12.2018 të Gjykatës Administrative të Apelit ka ushtruar rekurs pala e paditur. Në rekurs është kërkuar prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe të vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe pushimin e gjykimit të çështjes.

Në rekurs pala e paditur rekursuese ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë së bashku me rekursin. Në rekurs nuk ka asnjë pjesë që të argumentojë bazueshmërinë e kësaj kërkesë, përveç shkaqeve të rekursit të parashtruara në këtë akt procedural.

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoji relatimin e gjyqtarit, z. **Sokol Sadushi**, mbi kërkesën e pezullimit të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë,

VËREN:

1. FAKTET E ÇËSHTJES

1. **Gjykata Administrative të Shkallës së Parë Shkodër me Vendimin nr. 717, datë 22.09.2015** ka vendosur: “- *Pranimin e kërkesë padisë në këtë mënyrë: - Të konstatojë zgjidhjen e kontratës së punës së lidhur midis palës paditëse Gulit Hasanaj, palës së paditur, Zyra Vendore e Përmbartimit Shkodër, si zgjidhje me efekt të menjëhershëm e të pajustificuar. - Detyrimin e palës së paditur, Zyra Vendore e Përmbartimit Shkodër, për t’i dhënë palës paditëse, Gulit Hasanaj, pagë e shpërblim për dëmin si më poshtë: - 1. Pagën që do të kishte fituar nëse marrëdhënia e punës do të përfundonte në fund të afatit të njoftimit, për afatin legjitim 2 mujor. 2. Një dëmshpërblim prej 2 paga mujore për mosrespektim të procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës. 3. Një dëmshpërblim prej 6 muajsh pagë për zgjidhjen e menjëhershme e të pajustificuar të kontratës së punës.*”.

2. **Gjykata Administrative e Apelit me Vendimin nr. 4684, datë 21.12.2018** ka vendosur: “- *Lënien në fuqi të Vendimit nr. 717, datë 22.09.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.*”.

3. Kundër Vendimit nr. 4684, datë 21.12.2018 të Gjykatës Administrative të Apelit ka ushtruar rekurs pala e paditur. Në rekurs është kërkuar prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe të vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe pushimin e gjykimit të çështjes.

4. **Në rekurs pala e paditur rekursuese ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë së bashku me rekursin.** Në rekurs nuk ka asnjë pjesë që të argumentojë bazueshmërinë e kësaj kërkesë, përveç shkaqeve të rekursit të parashtruara në këtë akt procedural.

5. Rezulton se përmbartuesi gjyqësor ka realizuar njoftimin e debitorit për ekzekutimin vullnetar e më tej ka nisur ekzekutimi i detyrueshëm. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur të procedojë me njoftimin e palëve për kërkesën e palës së paditur për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë.

2. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

6. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “*Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ*” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm,

sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

7. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të riparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

8. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:

a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të riparueshme; dhe/ose

b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.

9. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të riparueshëm dhe të atçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;
- (nuk) cenohet rëndë interesi publik.

10. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të inicuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

11. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentat e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim.

12. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim. Nga ana tjetër abuzimi me mjetin ligjor të parashkuar

nga neni 479 i Kodit të Procedurës Civile mund të shkaktojë dhe aktivizimin e përgjegjësisë personale pasurore të palës apo përfaqësuesit, sipas pikës 1 të nenit 34 të Kodit.

13. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë është e pabazuar në ligj dhe si e tillë nuk duhet të pranohet. Gjykata e Lartë konstaton se shkaqet e rekursit janë paraqitur si shkaqe të kërkesës për pezullimin e vendimit të formës së prerë dhe për rrjedhojë kërkesa për pezullim nuk paraqet shkaqe të përligjura dhe që mundet të shqyrtohen në këtë gjykim të posaçëm të masave të përkohshme procedurale. Nga ana tjetër pala kërkuese nuk ka paraqitur argumentet dhe provat konkrete për vërtetimin e dëmit të pariparueshëm dhe të atëçastshëm që palës debitore mund t'i vijë nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Për rrjedhojë Kolegji konkludon se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë nuk mund të pranohet, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile.

PËR KËTO ARSYE:

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë mbështetur në Nenin 479 të Kodit të Procedurës Civile,

VENDOSI:

Mospranimin e kërkesës për pezullim të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit kundër Vendimin nr. 717, datë 22.09.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, të ndryshuar me Vendimin nr. 4684, datë 21.12.2018 të Gjykatës Administrative të Apelit.

Tiranë, me datë 04.05.2020

ANËTAR

ILIR PANDA

ANËTAR

ERVIN PUPE

KRYESUES

SOKOL SADUSHI



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

Nr. 98/434 Regjistri.

VENDIM

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

**SOKOL SADUSHI
ERVIN PUPE
ILIR PANDA**

**KRYESUES
ANËTAR
ANËTAR**

Sot më datë 04.05.2020, mori në shqyrtim në dhomë këshillimi kërkesën Nr. 434 Prot., datë 25.09.2019, si më poshtë:

KËRKUES: **GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR TIRANË**

PADITËS: **CARA MAT SH.P.K.**

I PADITUR: **GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR TIRANË**

OBJEKTI: Pezullimin e ekzekutimit të Vendimit 1538 (86-2018-1754), datë 16.05.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit si dhe të Vendimit nr. 5811 (80-2016-5840), datë 05.12.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

BAZA LIGJORE: Neni 479 i Kodit të Procedurës Civile.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me Vendimin Nr. 5811 (80-2016-5840), datë 05.12.2016 ka vendosur ndër të tjera: “1. Rrëzimin e padisë si të pabazuar në prova dhe në ligj. 2. Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës paditëse.”.

Gjykata Administrative e Apelit me Vendimin nr. 1538 (86-2018-1754), datë 16.05.2019 ka vendosur: “- Lëniën në fuqi të Vendimit Nr. 5811 (80-2016-5840), datë 05.12.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.”.

Kundër Vendimit nr. 1538 (86-2018-1754), datë 16.05.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit ka ushtruar rekurs pala e paditur Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Në rekurs është kërkuar prishja e vendimit të gjykatës së apelit dhe kthimi i çështjes për rigjykim.

Me datë 09.07.2019 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka paraqitur në Gjykatën e Lartë rekurs kundër vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit dhe bashkë me të

ka paraqitur një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë. Në kërkesë parashtrohet se:

- *Punimet janë kryer me mangësi dhe se kjo është konkluduar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit; Padia e paditësit është e bazuar në nenin 864 të Kodit Civil dhe se sipërmarrësi duhet të garantojë cilësinë e veprës së tij;*
- *Hetimi i kryer nga gjykatat e faktit është i mangët dhe se çështja duhet të kthehet për rigjykim në gjykatën e faktit;*
- *Shpenzimet gjyqësore nuk mundet të përballohen nga fondi i gjykatës pasi nuk ka buxhet;*
- *Nuk ka buxhet të planifikuar për ekzekutimin e këtij vendimi gjyqësor dhe se vendimi duhet të pezullohet, deri në shqyrtimin e rekursit nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë.*

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoi relatimin e gjyqtarit, z. **Sokol Sadushi**, mbi kërkesën e pezullimit të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë,

VËREN:

1. FAKTET E ÇËSHTJES

1. **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me Vendimin Nr. 5811 (80-2016-5840), datë 05.12.2016** ka vendosur ndër të tjera: “1. Rrëzimin e padisë si të pabazuar në prova dhe në ligj. 2. Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës paditëse.”.

2. **Gjykata Administrative e Apelit me Vendimin nr. 1538 (86-2018-1754), datë 16.05.2019** ka vendosur: “- Lënien në fuqi të Vendimit Nr. 5811 (80-2016-5840), datë 05.12.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.”.

3. Kundër Vendimit nr. 1538 (86-2018-1754), datë 16.05.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit ka ushtruar rekurs pala e paditur Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Në rekurs është kërkuar prishja e vendimit të gjykatës së apelit dhe kthimi i çështjes për rigjykim.

4. **Me datë 09.07.2019 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka paraqitur në Gjykatën e Lartë rekurs kundër vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit dhe bashkë me të ka paraqitur një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë. Në kërkesë parashtrohet se:**

- *Punimet janë kryer me mangësi dhe se kjo është konkluduar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit;*
- *Padia e paditësit është e bazuar në nenin 864 të Kodit Civil dhe se sipërmarrësi duhet të garantojë cilësinë e veprës së tij;*
- *Hetimi i kryer nga gjykatat e faktit është i mangët dhe se çështja duhet të kthehet për rigjykim në gjykatën e faktit;*
- *Shpenzimet gjyqësore nuk mundet të përballohen nga fondi i gjykatës pasi nuk ka buxhet;*
- *Nuk ka buxhet të planifikuar për ekzekutimin e këtij vendimi gjyqësor dhe se vendimi duhet të pezullohet, deri në shqyrtimin e rekursit nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë.*

5. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur të procedojë me njoftimin e palëve për kërkesën e palës së paditur për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë.

2. VLERËSIMI I KOLEGJIT ADMINISTRATIV TË GJYKATËS SË LARTË

6. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

7. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të riparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

8. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:

a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të riparueshme; dhe/ose

b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin e vendimit.”.

9. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të riparueshëm dhe të atçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;
- (nuk) cenohet rëndë interesi publik.

10. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të inicuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

11. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentat e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e

tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim.

12. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim. Nga ana tjetër abuzimi me mjetin ligjor të parashikuar nga neni 479 i Kodit të Procedurës Civile mund të shkaktojë dhe aktivizimin e përgjegjësive personale pasurore të palës apo përfaqësuesit, sipas pikës 1 të nenit 34 të Kodit.

13. Duke iu kthyer rastit konkret, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë është haptazi e pabazuar në ligj dhe si e tillë nuk duhet të pranohet. Njëkohësisht kërkesa objekt gjykimi konstatohet se është haptazi abuzive, pasi konstatohet se në këtë çështje është vendosur rrëzimi i padisë nga gjykata e shkallës së parë dhe se në gjykimin në apelit ky vendim është lënë në fuqi. Pikërisht ky vendim i gjykatës së apelit rekursohet nga pala paditëse dhe se kërkesa për pezullimin e ekzekutimit ka pikërisht këtë vendim të gjykatës së apelit si objekt. Vendimi i rrëzimit të padisë, sikurse vendimet jopërfundimtare të gjykatës, passjellin si pasojë automatike ligjore edhe detyrimin e palës paditëse që të paguajë shpenzimet gjyqësore, përveç kur palët kanë marrëveshje dhe në të kanë parashikuar ndryshe. Në kushtet kur pala kërkuese nuk e ka kontestuar këtë pjesë të vendimit të gjykatës së apelit me argumente konkret, Kolegji Administrativ konstaton se kërkesa për pezullim, sipas nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, në rastin konkret përbën abuzim me të drejtat procedurale.

14. Kolegji Administrativ sjellë në vëmendje se si rregull i përgjithshëm vendimet e rrëzimit të padisë nuk mund të përbëjnë tituj ekzekutiv sipas nenit 510 shkronja “a” të Kodit të Procedurës Civile dhe se për rrjedhojë përjashtohet apriori mundësia që ato të ekzekutohen dhe të sjellin rrezik apo pasoja të parikuperueshme në të drejtat subjektive dhe interesat e ligjshëm të palës rekursuese dhe njëkohësisht kërkuese. Duke qenë se kjo kërkesë është haptazi e pathemeltë dhe për më tepër abuzive, Kolegji Administrativ vlerëson se është vendi të procedohet me zbatimin e pikës 1 të nenit 34 të Kodit të Procedurës Civile.

15. Pika 1 e neni 34 të Kodit të Procedurës Civile parashikon se:

“1. Gjykata, në çdo shkallë të gjykimit, kur konstaton se palët ose përfaqësuesit e tyre me vetëdije paraqesin padi, ankime, kërkesa ose pretendime abuzive, ose të përsëritura dhe me keqdashje, ose kur kërkojnë qëllimisht të zvarrisin gjykimin, ose kur konstatohet se palët ose përfaqësuesit e tyre kanë fshehur ose shtrembëruar me keqbesim ose faj të rëndë, fakte dhe rrethana të rëndësishme që lidhen me çështjen, urdhëron me vendimin që jepet në përfundim të gjykimit, përveç kur në këtë Kod parashikohet ndryshe, gjorbitjen e përgjegjësimit në shumën nga 50 000 deri në 100 000 lekë. Kundër këtij vendimi lejohet ankim sipas rregullave për vendimet përfundimtare ose jopërfundimtare, në varësi të llojit të vendimit që i jep fund gjykimit përkatës.”

16. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se kjo pjesë e dispozitës ka synuar të aktivizojë përgjegjësinë e palëve dhe përfaqësuesve të tyre të cilët abuzojnë me të drejtat procedurale. Mjetet procedurale dhe të drejtat që ligji ofron nuk mund të pranohen të lejojnë dëmtimin e procesit të dhënies së drejtësisë. Ato nuk mund të shndërrohen në mekanizma që palët dhe përfaqësuesit e tyre t’i përdorin me keqbesim apo me qëllime të pamundësisë së zhvillimit të procesit apo dëmtimit të interesave dhe të drejtës së palës kundërshtare për të gëzuar efektivisht aksesin në drejtësi. Për rrjedhojë sa herë që konstatohen fakte të tilla të paligjshme në mënyrën se si një ndërgjyqës mbrohet apo e ushtron aktivitetin procedural gjykata duhet të sanksionojë përgjegjësinë pasurore për shkelje të këtij detyrimi ligjor. Qëllimi i kësaj norme është garantimi i mbarëvajtjes së procesit gjyqësor dhe detyrimi i subjekteve procedurale, qoftë ndërgjyqës apo qoftë përfaqësues, që të veprojnë dhe të ushtrojnë me mirëbesim të drejtat procedurale.

17. Gjykimi në Gjykatën e Lartë në këtë drejtim paraqet dy veçanti.

18. Fillimisht duhet të mbahet parasysh se neni 474 i Kodit të Procedurës Civile parashikon se rekursi i paraqitur në Gjykatën e Lartë duhet të nënshkruhet nga avokati që e përfaqëson palën dhe nëse pala e kërkon, edhe nga kjo e fundit. Nga ana tjetër neni 59 i Ligjit nr. 49/2012 parashikon se edhe kundërrekursi duhet të plotësojë kushtet formale që paraqet rekursi. Kjo do të thotë se qoftë mjetet e ankimit dhe qoftë mjetet e prejardhura të ankimit do të duhet të realizohen nga avokati në Gjykatën e Lartë, si një gjykatë ekskluzivisht me juridiksion të posaçëm ligjor. Nga këto parashikime konkludohet se aktet që i drejtohen Gjykatës së Lartë dhe që përbëjnë disponim të të drejtave procedurale të palëve aktivizojnë detyrimisht edhe përgjegjësinë e përfaqësuesit të palës. Ndaj këto të fundit janë personalisht përgjegjës sipas nenit 34 të Kodit të Procedurës Civile.

19. Nga ana tjetër, gjykimi në Gjykatën e Lartë, në rastin e zbatimit të sanksionit të parashikuar në nenin 34, pika 1 të Kodit të Procedurës Civile, nuk mundëson ushtrimin e ankimit të veçantë ndaj gjobës prej 50.000 Lekë – 100.000 Lekë që kjo gjykatë vendos. Në këto raste ankimi i veçantë që kjo dispozitë ofron nuk mund të zbatohet, pasi vendimi i Gjykatës së Lartë sipas nenit 482 dhe 485 të Kodit të Procedurës Civile dhe nenit 60/a dhe 63 të Ligjit nr. 49/2012 nuk mund të ankimohet gjyqësisht duke qenë se pushteti gjyqësor shteron pas ezaurimit të kësaj shkalle gjykimi.

20. Megjithatë Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se një palë apo përfaqësues i dënuar proceduralisht sipas pikës 1 të nenit 34 të Kodit të Procedurës Civile duhet të ketë mundësi të dëgjohet dhe të mbrohet lidhur me këtë sanksion, por se ligji procedural ka ometuar të japë një zgjidhje ligjore eksplicite në këtë drejtim. Me qëllimin që ndërgjyqësi apo përfaqësuesi i tij - i sanksionuar proceduralisht me gjobë për abuzim me të drejtat procedurale – të ketë mundësinë e një ankimi dhe mbi të gjitha të ketë mundësi të mbrohet mbi këtë vendim të Gjykatës së Lartë, Kolegji Administrativ vlerëson të nevojshme që nëpërmjet interpretimit pajtues të ligjit, që është në funksion të respektimit të së drejtës kushtetuese, të mos pengojë mundësinë e ankimit në gjykatë, për këto raste. Në bazë dhe për zbatim të paragrafit të dytë të nenit 1 të Kodit të Procedurës Civile, Kolegji Administrativ vlerëson se si zgjidhje në këtë rast duhet të ofrohet mjeti i posaçëm i ankimit i parashikuar në nenin 169 të Kodit të Procedurës Civile. Kjo dispozitë nën titullin “*Kundërshtimi i vendimit të dënimit*” parashikon se:

“Personat që janë dënuar me gjobë, sipas dispozitave të mësipërme, mund t’i paraqitin gjykatës që i ka dënuar, brenda tri ditëve, kërkesë për heqjen e dënimit, duke treguar dhe shkaqet.

Gjykata kur i gjen me vend këto shkaqe, revokon vendimin e dënimit me gjobë si dhe urdhrin e sjelljes me detyrim. Ajo mund edhe vetëm të pakësojë gjobën e caktuar. Në rast të kundërt, refuzon kërkesën.

Afati për të paraqitur kërkesën fillon nga dita e seancës gjyqësore dhe, në rastet e parashikuara nga nenet 165 dhe 167, nga dita e njoftimit të vendimit të dënimit.

Vendimi i dhënë nga gjykata në rastet e sipërme është i formës së prerë dhe kundër tij nuk lejohet ankim.”

21. Për rrjedhojë Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë konkludon se, ndaj vendimeve të Gjykatës së Lartë, në të cilat sanksionohen dënime procedurale me gjobë për ndërgjyqësin apo përfaqësuesin e tij, sipas pikës 1 të nenit 34 të Kodit të Procedurës Civile, lejohet ankim brenda tre ditëve nga dita e nesërme e marrjes dijeni për vendimin, para të njëjtit trup gjykues që ka dhënë vendimin e dënimit, duke treguar shkaqet dhe arsyet që justifikojnë kërkesën. Gjykata e Lartë e shqyrton këtë kërkesë në dhomë këshillimi dhe sipas rastit vendos pakësimin e gjobës, pranimin apo refuzimin e kërkesës. Në çdo rast, kundër vendimit të Gjykatës së Lartë, që ka vendosur pakësimin, pranimin apo refuzimin e kërkesës, nuk lejohet ankim.

22. Në rastet e vendimmarrjes së Gjykatës së Lartë, përmes së cilave caktohet një sanksion procedural gjëbor sipas pikës 1 të nenit 34 të Kodit të Procedurës Civile, një kopje e vendimit i njoftohet shërbimit përbarimor, konkretisht Zyrës Përbarimore Tiranë. Sipas shkronjës “a” të nenit 510 të Kodit të Procedurës Civile vendimet e Gjykatës së Lartë në këto raste përbëjnë tituj ekzekutiv dhe si të tilla janë të ekzekutueshme nga shërbimi përbarimor gjyqësor. Këto shuma detyrimi derdhen nga subjekti i dënuar debitor për llogari të buxhetit të shtetit.

23. Në rastin konkret kërkesa për pezullim është ushtruar pala paditëse, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Për rrjedhojë Kolegji Administrativ vendos që të dënojë Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në bazë dhe për zbatim të nenit 34 të Kodit të Procedurës Civile, me gjobë në vlerën 50.000 Lekë.

PËR KËTO ARSYE:

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë mbështetur në Nenin 479 të Kodit të Procedurës Civile,

VENDOSI:

Mospranimin e kërkesës për pezullim të palës paditëse, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, kundër Vendimit Nr. 5811 (80-2016-5840), datë 05.12.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me Vendimin nr.1538 (86-2018-1754), datë 16.05.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit.

Dënimin e palës kërkuese, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me gjobë në vlerën 50.000 Lekë.

Ky vendim përbën titull ekzekutiv.

Ngarkohet Zyra e Përbarimit Tiranë për ekzekutimin e gjobës për llogari të buxhetit të shtetit.

Një kopje e këtij vendimi i njoftohet edhe Zyrës së Përbarimit Tiranë.

Kundër pjesës së vendimit të dënimit me gjobë mund të ushtrohet ankim, brenda 3 ditëve nga dita e nesërme e marrjes dijeni të këtij vendimi, në Gjykatën e Lartë.

Tiranë, me datë 04.05.2020

ANËTAR

ILIR PANDA

ANËTAR

ERVIN PUPE

KRYESUES

SOKOL SADUSHI



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

Nr. 145/506 Regjistri.

VENDIM

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

**SOKOL SADUSHI
ERVIN PUPE
ILIR PANDA**

**KRYESUES
ANËTAR
ANËTAR**

Sot më datë 04.05.2020, mori në shqyrtim në dhomë këshillimi kërkesën Nr. 506 Prot., datë 25.11.2019, si më poshtë:

KËRKUES: **ZNJ. JONIDA TABAKU**

PADITËS: **ZNJ. JONIDA TABAKU**

I PADITUR: **QENDRA EKONOMIKE PËR ZHVILLIMIN DHE
EDUKIMIN E FËMIJËVE PRANË BASHKISË TIRANË**

OBJEKTI: Pezullimi i ekzekutimit të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit nr. 2571, datë 01.10.2019.

BAZA LIGJORE: Neni 479/a i Kodit të Procedurës Civile.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me Vendimin nr. 726 (80-2016-714), datë 19.02.2016 ka vendosur: “1. Pranimin e pjesshëm të padisë së paditëses Jonida Tabaku; 2. Detyrimin e të paditurit Qendra Ekonomike për Zhvillimin dhe Edukimin e Fëmijëve, Bashkia Tiranë, t’i paguajë paditëses dy paga mujore për shkak të mosrespektimit të procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës; 3. Detyrimin e të paditurit Qendra Ekonomike për Zhvillimin dhe Edukimin e Fëmijëve, Bashkia Tiranë, t’i paguajë paditëses dy paga mujore për shkak të mosrespektimit të afatit të njoftimit për zgjidhjen e kontratës së punës; 4. Detyrimin e të paditurit Qendra Ekonomike për Zhvillimin dhe Edukimin e Fëmijëve, Bashkia Tiranë, t’i paguajë paditëses 12 paga mujore për shkak të zgjidhjes së menjëhershme të pajustificuar të marrëdhënies së punës; 5. Rrëzimin e padisë për kërkesën e palës paditëse lidhur me dëmshpërblimin për shkaqe abuzive si të pabazuar në ligj dhe në prova. 6. Ky vendim përbën titull ekzekutiv kur merr formë të prerë...Gjykata pranon kërkesën e palës paditëse për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm...”

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë me Vendimin nr. 2571, datë 01.10.2019 ka vendosur: *“1. Ndryshimin pjesërisht të vendimit nr. 726, datë 19.02.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. 2. Detyrimin e palës së paditur t’i paguajë paditëses Jonida Tabaku 3 (tre) paga mujore si dëmshpërblim për zgjidhje të menjëhershme e të pajustificuar të kontratës së punës. 3. Lënien në fuqi për pjesën tjetër...”*

Kundër Vendimit nr. 2571, datë 01.10.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë ka ushtruar rekurs, pala paditëse, Jonida Tabaku dhe po ashtu me datë 18.11.2019, pala paditëse, ka paraqitur kërkesë për pezullimin e vendimit të sipërcituar, sipas nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, duke parashtruar këto shkaqe:

- *Ekzekutimi i këtij vendimi do të sillte pasoja të rënda dhe të pariparueshme për paditësen, e cila është nënë e dy fëmijëve të mitur dhe jeton në një banesë me qera;*
- *Që prej vitit 2015 ajo ka qënë e papunë dhe ka arritur të punësohet në vitin 2018 me një pagë bruto 26 000 ALL;*
- *Bashkëshorti i paditëses ka kaluar një sëmundje të rëndë, i është nënshtuar një operacioni të vështirë dhe pasojat e sëmundjes vijnë edhe sot.*

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoji relatimin e gjyqtarit, z. **Sokol Sadushi**, mbi kërkesën e pezullimit të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë,

VËREN:

1. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Para Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (në vijim Kolegji), kërkuesi, znj. Jonida Tabaku ka paraqitur kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 2571, datë 01.10.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, duke paraqitur si shkaqe, ato të parashtruara në pjesën hyrëse.

2. Referuar akteve të administruara në gjykatat e faktit rezulton se paditësi, znj. Jonida Tabaku, i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me padi me objekt shpërblim dëmi për zgjidhje të paligjshme të kontratës së punës, kundrejt palës së paditur, Qendra Ekonomike për Zhvillimin dhe Edukimin e Fëmijëve, Bashkia Tiranë.

3. **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me Vendimin nr. 726 (80-2016-714), datë 19.02.2016** ka vendosur: *“1. Pranimin e pjesshëm të padisë së paditëses Jonida Tabaku; 2. Detyrimin e të paditurit Qendra Ekonomike për Zhvillimin dhe Edukimin e Fëmijëve, Bashkia Tiranë, t’i paguajë paditëses dy paga mujore për shkak të mosrespektimit të procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës; 3. Detyrimin e të paditurit Qendra Ekonomike për Zhvillimin dhe Edukimin e Fëmijëve, Bashkia Tiranë, t’i paguajë paditëses dy paga mujore për shkak të mosrespektimit të afatit të njoftimit për zgjidhjen e kontratës së punës; 4. Detyrimin e të paditurit Qendra Ekonomike për Zhvillimin dhe Edukimin e Fëmijëve, Bashkia Tiranë, t’i paguajë paditëses 12 paga mujore për shkak të zgjidhjes së menjëhershme të pajustificuar të marrëdhënies së punës; 5. Rrëzimin e padisë për kërkesën e palës paditëse lidhur me dëmshpërblimin për shkaqe abuzive si të pabazuar në ligj dhe në prova. 6. Ky vendim përbën*

titull ekzekutiv kur merr formë të prerë...Gjykata pranon kërkesën e palës paditëse për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm...”

4. **Gjykata Administrative e Apelit Tiranë me Vendimin nr. 2571, datë 01.10.2019** ka vendosur: “1. Ndryshimin pjesërisht të vendimit nr. 726, datë 19.02.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. 2. Detyrimin e palës së paditur t’i paguajë paditëses Jonida Tabaku 3 (tre) paga mujore si dëmshpërblim për zgjidhje të menjëhershme e të pajustificuar të kontratës së punës. 3. Lënien në fuqi për pjesën tjetër...”.

5. **Kundër Vendimit nr. 2571, datë 01.10.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë** ka ushtruar rekurs, pala paditëse, Jonida Tabaku dhe po ashtu me datë 18.11.2019, pala paditëse, ka paraqitur kërkesë për pezullimin e vendimit të sipërcituar, sipas nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, duke parashtruar këto shkaqe:

- *Ekzekutimi i këtij vendimi do të sillte pasoja të rënda dhe të pariparueshme për paditësen, e cila është nënë e dy fëmijëve të mitur dhe jeton në një banesë me qera;*
- *Që prej vitit 2015 ajo ka qënë e papunë dhe ka arritur të punësohet në vitin 2018 me një pagë bruto 26 000 ALL;*
- *Bashkëshorti i paditëses ka kaluar një sëmundje të rëndë, i është nënshtuar një operacioni të vështirë dhe pasojat e sëmundjes vijnë edhe sot.*

II. VLERËSIMI I KOLEGJIT ADMINISTRATIV TË GJYKATËS SË LARTË

6. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

7. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

8. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:

a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme; dhe/ose

b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.

9. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të riparueshëm dhe të atëçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;
- (nuk) cenohet rëndë interesi publik.

10. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të inicuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

11. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentat e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim.

12. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim. Nga ana tjetër abuzimi me mjetin ligjor të parashikuar nga neni 479 i Kodit të Procedurës Civile mund të shkaktojë dhe aktivizimin e përgjegjësisë personale pasurore të palës apo përfaqësuesit, sipas pikës 1 të nenit 34 të Kodit.

13. Duke iu kthyer rastit konkret, Kolegji Administrativ vlerëson se kërkesa e paditëses, znj. Jonida Tabaku, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të sipërcituar është e pabazuar në ligj. Kolegji vlerëson se paditësi, në cilësinë e kreditorit gjyqësor nuk legjitimohet të kërkojë pezullimin e ekzekutimit të një vendimi gjyqësor të formës së prerë sipas nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile.

14. Kolegji vlerëson se neni 479/1 i Kodit të Procedurës Civile garanton vendosjen e masës së përkohshme procedurale të pezullimit të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë në funksion të zgjidhjes së rekursit, që është ushtruar ndaj vetë vendimit të formës së prerë, sigurisht duke patur parasysh arsyet justifikuese të zbatimit të kësaj mase, sikur mundet të jetë dëmi i rëndë dhe i riparueshëm që mund të sjellë ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Pavarësisht se në nenin 479/1 të Kodi i Procedurës Civile, është përdorur termin e përgjithshëm “palë” nisur nga qëllimi që ndjek masa e pezullimit të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në mënyrë logjike konkludohet se kjo dispozitë legjitimon për të kërkuar pezullimin e ekzekutimit të vendimit palën ndërgjyqëse gjyqëmbëse, e cila në fazën e ekzekutimit të vendimit merr cilësinë e debitorit, të ngarkuar me

vendimin gjyqësor për përmbushjen e një detyrimi. Kjo e drejtë është paraparë nga ligji procedural civil si mjet që garanton ankimin efektiv në kuptim të nenit 43 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 13 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut.

15. Në vijim të këtij arsyetimi, Kolegji vlerëson se tek vendimet e detyrimit, që plotësojnë cilësinë e titullit ekzekutiv sipas nenit 510 të Kodi i Procedurës Civile debitori gjyqumbës, i cili është ngarkuar me vendim gjyqësor të formës së prerë me përmbushjen e një detyrimi, ka të drejtë të kërkojë sipas nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile pezullimin e ekzekutimit të këtij vendimi nëse nga ekzekutimi i menjëhershëm atij mund t'i vijë pasoja të rënda dhe të pariparueshme.

16. Kolegji Administrativ konstaton se paditësja në vendimin objekt rekursi gëzon cilësinë e kreditorit gjyqfitues në fazën e ekzekutimit të detyrueshëm të vendimit gjyqësor të formës së prerë. Si e tillë, në kuptim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile ajo nuk legjitimohet dhe nuk ka interes të ligjshëm të kërkojë pezullimin e ekzekutimit të titullit ekzekutiv në favor të tij. Përsa më sipër, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë konstaton se kërkesa është haptazi e pathemeltë dhe abuzive, duke konkluduar sakaq se është vendi të procedohet me zbatimin e pikës 1 të nenit 34 të Kodit të Procedurës Civile.

17. Pika 1 e neni 34 të Kodit të Procedurës Civile parashikon se:

“1. Gjykata, në çdo shkallë të gjykimit, kur konstaton se palët ose përfaqësuesit e tyre me vetëdije paraqesin padi, ankime, kërkesa ose pretendime abuzive, ose të përsëritura dhe me keqdashje, ose kur kërkojnë qëllimisht të zvarrisin gjykimin, ose kur konstatohet se palët ose përfaqësuesit e tyre kanë fshehur ose shtrembëruar me keqbesim ose faj të rëndë, fakte dhe rrethana të rëndësishme që lidhen me çështjen, urdhëron me vendimin që jepet në përfundim të gjykimit, përveç kur në këtë Kod parashikohet ndryshe, gjobitjen e përgjegjësit në shumën nga 50 000 deri në 100 000 lekë. Kundër këtij vendimi lejohet ankim sipas rregullave për vendimet përfundimtare ose jopërfundimtare, në varësi të llojit të vendimit që i jep fund gjykimit përkatës.”

18. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se kjo pjesë e dispozitës ka synuar të aktivizojë përgjegjësinë e palëve dhe përfaqësuesve të tyre të cilët abuzojnë me të drejtat procedurale. Mjetet procedurale dhe të drejtat që ligji ofron nuk mund të pranohen të lejojnë dëmtimin e procesit të dhënies së drejtësisë. Ato nuk mund të shndërrohen në mekanizma që palët dhe përfaqësuesit e tyre t'i përdorin me keqbesim apo me qëllime të pamundësisë së zhvillimit të procesit apo dëmtimit të interesave dhe të drejtës së palës kundërshtarë për të gëzuar efektivisht aksesin në drejtësi. Për rrjedhojë sa herë që konstatohen fakte të tilla të paligjshme në mënyrën se si një ndërgjyqës mbrohet apo e ushtron aktivitetin procedural gjykata duhet të sanksionojë përgjegjësinë pasurore për shkelje të këtij detyrimi ligjor. Qëllimi i kësaj norme është garantimi i mbarëvajtjes së procesit gjyqësor dhe detyrimi i subjekteve procedurale, qoftë ndërgjyqës apo qoftë përfaqësues, që të veprojnë dhe të ushtrojnë me mirëbesim të drejtat procedurale.

19. Gjykimi në Gjykatën e Lartë në këtë drejtim paraqet dy veçanti.

20. Fillimisht duhet të mbahet parasysh se neni 474 i Kodit të Procedurës Civile parashikon se rekursi i paraqitur në Gjykatën e Lartë duhet të nënshkruhet nga avokati që e përfaqëson palën dhe nëse pala e kërkon, edhe nga kjo e fundit. Nga ana tjetër neni 59 i Ligjit nr. 49/2012 parashikon se edhe kundërrekursi duhet të plotësojë kushtet formale që paraqet rekursi. Kjo do të thotë se qoftë mjetet e ankimit dhe qoftë mjetet e prejardhura të ankimit do të duhet të realizohen nga avokati në Gjykatën e Lartë, si një gjykatë ekskluzivisht me juridiksion të posaçëm ligjor. Nga këto parashikime konkludohet se aktet që i drejtohen Gjykatës së Lartë dhe që përbëjnë disponim të të drejtave procedurale të palëve aktivizojnë detyrimisht edhe

përgjegjësinë e përfaqësuesit të palës. Ndaj këto të fundit janë personalisht përgjegjës sipas nenit 34 të Kodit të Procedurës Civile.

21. Nga ana tjetër, gjykimi në Gjykatën e Lartë, në rastin e zbatimit të sanksionit të parashikuar në nenin 34, pika 1 të Kodit të Procedurës Civile, nuk mundëson ushtrimin e ankimit të veçantë ndaj gjobës prej 50.000 Lekë – 100.000 Lekë që kjo gjykatë vendos. Në këto raste ankimi i veçantë që kjo dispozitë ofron nuk mund të zbatohet, pasi vendimi i Gjykatës së Lartë sipas nenit 482 dhe 485 të Kodit të Procedurës Civile dhe nenit 60/a dhe 63 të Ligjit nr. 49/2012 nuk mund të ankimohet gjyqësisht duke qenë se pushteti gjyqësor shteron pas ezaurimit të kësaj shkalë gjykimi.

22. Megjithatë Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se një palë apo përfaqësues i dënuar proceduralisht sipas pikës 1 të nenit 34 të Kodit të Procedurës Civile duhet të ketë mundësi të dëgjohet dhe të mbrohet lidhur me këtë sanksion, por se ligji procedural ka ometuar të japë një zgjidhje ligjore eksplicite në këtë drejtim. Me qëllimin që ndërgjyqësi apo përfaqësuesi i tij - i sanksionuar proceduralisht me gjobë për abuzim me të drejtat procedurale – të ketë mundësinë e një ankimi dhe mbi të gjitha të ketë mundësi të mbrohet mbi këtë vendim të Gjykatës së Lartë, Kolegji Administrativ vlerëson të nevojshme që nëpërmjet interpretimit pajtues të ligjit, që është në funksion të respektimit të së drejtës kushtetuese, të mos pengojë mundësinë e ankimit në gjykatë, për këto raste. Në bazë dhe për zbatim të paragrafit të dytë të nenit 1 të Kodit të Procedurës Civile, Kolegji Administrativ vlerëson se si zgjidhje në këtë rast duhet të ofrohet mjeti i posaçëm i ankimit i parashikuar në nenin 169 të Kodit të Procedurës Civile. Kjo dispozitë nën titullin “*Kundërshtimi i vendimit të dënimit*” parashikon se:

“Personat që janë dënuar me gjobë, sipas dispozitave të mësipërme, mund t’i paraqitin gjykatës që i ka dënuar, brenda tri ditëve, kërkesë për heqjen e dënimit, duke treguar dhe shkaqet.

Gjykata kur i gjen me vend këto shkaqe, revokon vendimin e dënimit me gjobë si dhe urdhrin e sjelljes me detyrim. Ajo mund edhe vetëm të pakësojë gjobën e caktuar. Në rast të kundërt, refuzon kërkesën.

Afati për të paraqitur kërkesën fillon nga dita e seancës gjyqësore dhe, në rastet e parashikuara nga nenet 165 dhe 167, nga dita e njoftimit të vendimit të dënimit.

Vendimi i dhënë nga gjykata në rastet e sipërme është i formës së prerë dhe kundër tij nuk lejohet ankim.”

23. Për rrjedhojë Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë konkludon se, ndaj vendimeve të Gjykatës së Lartë, në të cilat sanksionohen dënime procedurale me gjobë për ndërgjyqësin apo përfaqësuesin e tij, sipas pikës 1 të nenit 34 të Kodit të Procedurës Civile, lejohet ankim brenda tre ditëve nga dita e nesërme e marrjes dijeni për vendimin, para të njëjtit trup gjykues që ka dhënë vendimin e dënimit, duke treguar shkaqet dhe arsyet që justifikojnë kërkesën. Gjykata e Lartë e shqyrton këtë kërkesë në dhomë këshillimi dhe sipas rastit vendos pakësimin e gjobës, pranimin apo refuzimin e kërkesës. Në çdo rast, kundër vendimit të Gjykatës së Lartë, që ka vendosur pakësimin, pranimin apo refuzimin e kërkesës, nuk lejohet ankim.

24. Në rastet e vendimmarrjes së Gjykatës së Lartë, përmes së cilave caktohet një sanksion procedural gjobor sipas pikës 1 të nenit 34 të Kodit të Procedurës Civile, një kopje e vendimit i njoftohet shërbimit përbarimor, konkretisht Zyrës Përbarimore Tiranë. Sipas shkronjës “a” të nenit 510 të Kodit të Procedurës Civile vendimet e Gjykatës së Lartë në këto raste përbëjnë tituj ekzekutiv dhe si të tilla janë të ekzekutueshme nga shërbimi përbarimor gjyqësor. Këto shuma detyrimi derdhen nga subjekti i dënuar debitor për llogari të buxhetit të shtetit.

25. Në rastin konkret kërkesa për pezullim është ushtruar dhe hartuar nga avokati i palës paditëse, z. Ilir Simaku. Për rrjedhojë Kolegji Administrativ vendos që të dënojë avokatin Ilir Simaku, në bazë dhe për zbatim të nenit 34 të Kodit të Procedurës Civile, me gjobë në vlerën 50.000 Lekë.

PËR KËTO ARSYE:

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, bazuar në Nenin 34 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile,

VENDOSI:

Mospranimin e kërkesës për pezullim të palës paditëse, znj. Jonida Tabaku, kundër Vendimit nr. 726 (80-2016-714), datë 19.02.2016 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, të ndryshuar me Vendimin nr. 2571, datë 01.10.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit.

Dënimin e përfaqësuesit të palës kërkuese, avokatin Ilir Simaku, me gjobë në vlerën 50.000 lekë.

Ky vendim përbën titull ekzekutiv.

Ngarkohet Zyra e Përmbartimit Tiranë për ekzekutimin e gjobës për llogari të buxhetit të shtetit.

Një kopje e këtij vendimi i njoftohet edhe Zyrës së Përmbartimit Tiranë.

Kundër pjesës së vendimit të dënimit me gjobë mund të ushtrohet ankim, brenda 3 ditëve nga dita e nesërme e marrjes dijeni të këtij vendimi, në Gjykatën e Lartë.

Tiranë, me datë 04.05.2020

ANËTAR

ANËTAR

KRYESUES

ILIR PANDA

ERVIN PUPE

SOKOL SADUSHI



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

Nr. 49/333 Regjistri.

VENDIM

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

**SOKOL SADUSHI
ERVIN PUPE
ILIR PANDA**

**KRYESUES
ANËTAR
ANËTAR**

Sot më datë 04.05.2020, mori në shqyrtim në dhomë këshillimi kërkesën Nr. 333 Prot., datë 18.06.2019, si më poshtë:

KËRKUES: **MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË**

PADITËS: **Z. KLEJDI YZEIRAJ**

I PADITUR: **MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DEGA E THESARIT TIRANË**

PERSON I TRETË: **PROKURORIA E RRETHIT GJYQËSOR TIRANË**

OBJEKTI: Kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të Vendimit nr. 1375, datë 02.05.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

BAZA LIGJORE: Neni 479 i Kodit të Procedurës Civile.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me Vendimin Nr. 3256 (80-2017-3313), datë 21.07.2017 ka vendosur ndër të tjera: “- *Pranimin e pjesshëm të padisë. – Detyrimin e palëve të paditura t’i paguajnë paditësit shumën 62.000 Lekë si kompensim për periudhën e burgimit të padrejtë të kryer prej tij. – Rrëzimin e padisë për kërkimet e tjera.*”.

Gjykata Administrative e Apelit me Vendimin nr. 1375, datë 02.05.2019 ka vendosur: “*Lëniën në fuqi të Vendimit nr. 3256, datë 21.07.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.*”.

Kundër Vendimit nr. 1375, datë 02.05.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit ka ushtruar rekurs pala e paditur, Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Në rekurs është kërkuar ndryshimi i vendimeve të të dy gjykatave të faktit dhe rrëzimi i padisë si e papabuar në ligj.

Me datë 03.12.2018 Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë. Në kërkesë parashtrohet se:

- *Përmbaruesi gjyqësor ka sjellë lajmërimin për ekzekutim vullnetar dhe kanë nisur procedurat e ekzekutimit të detyrueshëm;*
- *Pala paditëse ka qendruar në paraburgim për 31 ditë dhe se në rrethanat e çështjes ndodhemi para rastit të përjashtimit nga e drejta e kompensimit dhe padia duhet të ishte rrëzuar si e pabazuar në ligj dhe në prova nga gjykata;*
- *Kanë qenë veprimet e të pandehurit të cilat kanë krijuar dyshimet e arsyeshme se ka qenë ai personi i cili ka kryer veprën penale për të cilën është ndaluar dhe për të cilën është akuzuar;*
- *Nuk ka buxhet të planifikuar për ekzekutimin e këtij vendimi gjyqësor dhe se vendimi duhet të pezullohet, deri në shqyrtimin e rekursit nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë.*

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoi relatimin e gjyqtarit, z. **Sokol Sadushi**, mbi kërkesën e pezullimit të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë,

VËREN:

1. FAKTET E ÇËSHTJES

1. **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me Vendimin Nr. 3256 (80-2017-3313), datë 21.07.2017** ka vendosur ndër të tjera: “- *Pranimin e pjesshëm të padisë. – Detyrimin e palëve të paditura t’i paguajnë paditësit shumën 62.000 Lekë si kompensim për periudhën e burgimit të padrejtë të kryer prej tij. – Rrëzimin e padisë për kërkimet e tjera.*”.

2 **Gjykata Administrative e Apelit me Vendimin nr. 1375, datë 02.05.2019** ka vendosur: “*Lënien në fuqi të Vendimit nr. 3256, datë 21.07.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.*”.

3. Kundër Vendimit nr. 1375, datë 02.05.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit ka ushtruar rekurs pala e paditur, Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Në rekurs është kërkuar ndryshimi i vendimeve të të dy gjykatave të faktit dhe rrëzimi i padisë si e pabazuar në ligj.

4. **Me datë 03.12.2018 Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë. Në kërkesë parashtrohet se:**

- *Përmbaruesi gjyqësor ka sjellë lajmërimin për ekzekutim vullnetar dhe kanë nisur procedurat e ekzekutimit të detyrueshëm;*
- *Pala paditëse ka qendruar në paraburgim për 31 ditë dhe se në rrethanat e çështjes ndodhemi para rastit të përjashtimit nga e drejta e kompensimit dhe padia duhet të ishte rrëzuar si e pabazuar në ligj dhe në prova nga gjykata;*
- *Kanë qenë veprimet e të pandehurit të cilat kanë krijuar dyshimet e arsyeshme se ka qenë ai personi i cili ka kryer veprën penale për të cilën është ndaluar dhe për të cilën është akuzuar;*
- *Nuk ka buxhet të planifikuar për ekzekutimin e këtij vendimi gjyqësor dhe se vendimi duhet të pezullohet, deri në shqyrtimin e rekursit nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë.*

5. Rezulton përmbaruesi gjyqësor ka realizuar njoftimin e debitorit për ekzekutimin vullnetar. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur të procedojë me njoftimin e palëve për kërkesën e palës së paditur për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë.

2. VLERËSIMI I KOLEGJIT ADMINISTRATIV TË GJYKATËS SË LARTË

6. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

7. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

8. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:

a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme; dhe/ose

b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.

9. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të pariparueshëm dhe të atçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;
- (nuk) cenohet rëndë interesi publik.

10. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të inicuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

11. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret

ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentat e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim.

12. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim. Nga ana tjetër abuzimi me mjetin ligjor të parashikuar nga neni 479 i Kodit të Procedurës Civile mund të shkaktojë dhe aktivizimin e përgjegjësive personale pasurore të palës apo përfaqësuesit, sipas pikës 1 të nenit 34 të Kodit.

13. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë është e pabazuar në ligj dhe si e tillë nuk duhet të pranohet. Gjykata e Lartë konstaton se shkaqet e rekursit janë paraqitur si shkaqe të kërkesës për pezullimin e vendimit të formës së prerë dhe për rrjedhojë kërkesa për pezullim nuk paraqet shkaqe të përligjura dhe që mundet të shqyrtohen në këtë gjykim të posaçëm të masave të përkohshme procedurale. Nga ana tjetër pala kërkuese nuk ka paraqitur argumentet dhe provat konkrete për vërtetimin e dëmit të riparueshëm dhe të atëçastshëm që palës debitore mund t'i vijë nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Për rrjedhojë Kolegji konkludon se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë nuk mund të pranohet, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile.

Për këto arsye:

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë mbështetur në Nenin 479 të Kodit të Procedurës Civile,

Vendosi:

Mospranimin e kërkesës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për pezullimin e ekzekutimit të Vendimit Nr. 3256 (80-2017-3313), datë 21.07.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me Vendimin nr. 1375, datë 02.05.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit.

Tiranë, me datë 04.05.2020

ANËTAR

ILIR PANDA

ANËTAR

ERVIN PUPE

KRYESUES

SOKOL SADUSHI



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

Nr. 34/308 Regjistri.

VENDIM

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

SOKOL SADUSHI	KRYESUES
ERVIN PUPE	ANËTAR
ILIR PANDA	ANËTAR

Sot më datë 04.05.2020, mori në shqyrtim në dhomë këshillimi kërkesën Nr. 308 Prot., datë 27.05.2019, si më poshtë:

KËRKUES: **DREJTORIA RAJONALE E KULTURËS KOMBËTARE
GJIROKASTËR**

PADITËS: **Z. KUJTIM DUMI**

I PADITUR: **DREJTORIA RAJONALE E KULTURËS KOMBËTARE
GJIROKASTËR**

OBJEKTI: Pezullim i ekzekutimit të titullit ekzekutiv.
Vendimi Gjyqësor nr. 68, datë 02.02.2016 të Gjykatës Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastër, lënë në fuqi me Vendimin nr. 1113, datë 09.04.2019 të Gjykatës së Apelit Administrativ Tiranë.

BAZA LIGJORE: Neni 479 i Kodit të Procedurës Civile.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastër me Vendimin Nr. 68, datë 02.02.2016 ka vendosur ndër të tjera: *“Pranimin e padisë pjesërisht. Detyrimin e palës së paditur, Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Gjirokastër të paguajë padisë, Kujtim Dumi, 25 paga mujore dëmshpërblim për zgjidhjen e kontratës së punës. Rrëzimin e padisë për pjesën tjetër të objektit.”*.

Gjykata Administrative e Apelit me Vendimin nr. 1113, datë 09.04.2019 ka vendosur: *“Lëniën në fuqi të Vendimit nr. 68, datë 02.02.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër.”*.

Kundër Vendimit nr. 1113, datë 09.04.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit ka ushtruar rekurs pala e paditur, Drejtoria Rajonale e Kulturës Gjirokastër. Në rekurs është kërkuar prishja e vendimit të gjykatës së apelit dhe dërgimi i çështjes për rigjykim në apel.

Me datë 27.05.2019 Drejtoria Rajonale e Kulturës Gjirokastrë ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë. Në kërkesë parashtrohet se:

- *Duke qenë se kanë nisur procedurat e ekzekutimit të detyrueshëm dhe çështja pret një zgjidhje përfundimtare, atëhere duhet që Gjykata e Lartë të pezullojë vendimin gjyqësor të formës së prerë, derisa të zgjidhet çështja;*
- *Nëse vendimi gjyqësor ekzekutohet atëhere do të rrezikohet veprimtaria e institucionit dhe nuk do munden të përmbushen shërbimet dhe detyrimet ligjore kundrejt qytetarëve;*
- *Nuk ka buxhet të planifikuar për ekzekutimin e këtij vendimi gjyqësor dhe se vendimi duhet të pezullohet, deri në shqyrtimin e rekursit nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë.*

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoji relatimin e gjyqtarit, z. **Sokol Sadushi**, mbi kërkesën e pezullimit të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë,

VËREN:

1. FAKTET E ÇËSHTJES

1. **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë me Vendimin Nr. 68, datë 02.02.2016** ka vendosur ndër të tjera: *“Pranimin e padisë pjesërisht. Detyrimin e palës së paditur, Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Gjirokastrë të paguajë padisë, Kujtim Dumi, 25 paga mujore dëmshpërblim për zgjidhjen e kontratës së punës. Rrëzimin e padisë për pjesën tjetër të objektit.”.*

2. **Gjykata Administrative e Apelit me Vendimin nr. 1113, datë 09.04.2019** ka vendosur: *“- Lënien në fuqi të Vendimit nr. 68, datë 02.02.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë.”.*

3. Kundër Vendimit nr. 1113, datë 09.04.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit ka ushtruar rekurs pala e paditur, Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Gjirokastrë. Në rekurs është kërkuar prishja e vendimit të gjykatës së apelit dhe dërgimi i çështjes për rigjykim në apel.

4. **Me datë 27.05.2019 Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Gjirokastrë ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë. Në kërkesë parashtrohet se:**

- *Duke qenë se kanë nisur procedurat e ekzekutimit të detyrueshëm dhe çështja pret një zgjidhje përfundimtare, atëhere duhet që Gjykata e Lartë të pezullojë vendimin gjyqësor të formës së prerë, derisa të zgjidhet çështja;*
- *Nëse vendimi gjyqësor ekzekutohet atëhere do të rrezikohet veprimtaria e institucionit dhe nuk do munden të përmbushen shërbimet dhe detyrimet ligjore kundrejt qytetarëve;*
- *Nuk ka buxhet të planifikuar për ekzekutimin e këtij vendimi gjyqësor dhe se vendimi duhet të pezullohet, deri në shqyrtimin e rekursit nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë.*

5. Rezulton se përmbaruesi gjyqësor ka realizuar njoftimin e debitorit për ekzekutimin vullnetar. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur të procedojë me njoftimin e palëve për kërkesën e palës së paditur për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë.

2. VLERËSIMI I KOLEGJIT ADMINISTRATIV TË GJYKATËS SË LARTË

6. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

7. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atçastshëm dhe eminent për shkakimin e një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

8. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:

a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme; dhe/ose

b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.

9. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të pariparueshëm dhe të atçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;
- (nuk) cenohet rëndë interesi publik.

10. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të inicuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

11. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar

dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentat e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim.

12. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim. Nga ana tjetër abuzimi me mjetin ligjor të parashikuar nga neni 479 i Kodit të Procedurës Civile mund të shkaktojë dhe aktivizimin e përgjegjësisë personale pasurore të palës apo përfaqësuesit, sipas pikës 1 të nenit 34 të Kodit.

13. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë është e pabazuar në ligj dhe si e tillë nuk duhet të pranohet. Gjykata e Lartë konstaton se shkaqet e rekursit janë paraqitur si shkaqe të kërkesës për pezullimin e vendimit të formës së prerë dhe për rrjedhojë kërkesa për pezullim nuk paraqet shkaqe të përligjura dhe që mundet të shqyrtohen në këtë gjykim të posaçëm të masave të përkohshme procedurale. Nga ana tjetër pala kërkuese nuk ka paraqitur argumentet dhe provat konkrete për vërtetimin e dëmit të riparueshëm dhe të atëçastshëm që palës debitore mund t'i vijë nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Për rrjedhojë Kolegji konkludon se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë nuk mund të pranohet, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile.

PËR KËTO ARSYE:

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë mbështetur në Nenin 479 të Kodit të Procedurës Civile,

VENDOSI:

Mospranimin e kërkesës së Drejtorisë Rajonale të Kulturës Kombëtare Gjirokastrë për pezullimin e Vendimit Nr. 68, datë 02.02.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, i lënë në fuqi me Vendimin nr. 1113, datë 09.04.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit.

Tiranë, me datë 04.05.2020

ANËTAR

ILIR PANDA

ANËTAR

ERVIN PUPE

KRYESUES

SOKOL SADUSHI



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

Nr. 119/459 Regjistri.

VENDIM

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

**SOKOL SADUSHI
ERVIN PUPE
ILIR PANDA**

**KRYESUES
ANËTAR
ANËTAR**

Sot më datë 04.05.2020, mori në shqyrtim në dhomë këshillimi kërkesën Nr. 459 Prot., datë 07.10.2019, si më poshtë:

KËRKUES: **AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS**

PADITËS: **Z. MORAND HOXHA**

I PADITUR: **AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS**

OBJEKTI: Pezullim i ekzekutimit të Vendimit nr. 1943, datë 20.06.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

BAZA LIGJORE: Neni 479 i Kodit të Procedurës Civile.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë me Vendimin Nr. 94, datë 04.02.2016 ka vendosur ndër të tjera: “1. Pranimin e pjesshëm të kërkesë padisë. 2. Detyrimin e palës së paditur që t’i paguajë paditësit, Morande Hoxha, një dëmshpërblim prej 6 muaj pagë për shkak të zgjidhjes së menjëhershme e të pajustificuar të kontratës së punës. 3. Detyrimin e palës së paditur që t’i paguajë paditësit një shpërblim prej 1 muaj pagë për mosrespektim të afatit të njoftimit për zgjidhjen e kontratës së punës. 4. Detyrimin e palës së paditur t’i paguajë paditësit një dëmshpërblim prej 2 muajsh pagë për mosrespektim të procedurës për zgjidhjen e kontratës së punës. 5. Rrëzimin për pjesën tjetër të kërkesëpadisë.”.

Gjykata Administrative e Apelit me Vendimin nr. 1943, datë 20.06.2019 ka vendosur: “- Ndryshimin e Vendimit nr. 94 (101), datë 04.02.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë. – Pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë. – Detyrimin e palës së paditur t’i paguajë paditësit, Morande Hoxha, pagën për periudhën 10.10.2013 – 31.12.2013. – Rrëzimin e padisë për kërkimet e tjera. – Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës së paditur.”.

Kundër Vendimit nr. 1943, datë 20.06.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit ka ushtruar rekurs pala e paditur, Agjencia Shtetërore e Kadastrës. Në rekurs është kërkuar ndryshimi i vendimeve të dy gjykatave të faktit dhe rrëzimi i padisë si e pabazuar në ligj.

Me datë 07.10.2019 Agjencia Shtetërore e Kadastrës ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë.

Në kërkesë parashtrohet se:

- *Ndaj vendimit të gjykatës së apelit është ushtruar rekurs;*
- *Bazuar në nenin 479 të Kodit të procedurës Civile vendimi objekt rekursi duhet të pezullohet dhe të mosekzekutohet.*

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoi relatimin e gjyqtarit, z. **Sokol Sadushi**, mbi kërkesën e pezullimit të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë,

VËREN:

1. FAKTET E ÇËSHTJES

1. **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë me Vendimin Nr. 94, datë 04.02.2016** ka vendosur ndër të tjera: “1. Pranimin e pjesshëm të kërkesë padisë. 2. Detyrimin e palës së paditur që t’i paguajë paditësit, Morande Hoxha, një dëmshpërblim prej 6 muaj pagë për shkak të zgjidhjes së menjëhershme e të pajustificuar të kontratës së punës. 3. Detyrimin e palës së paditur që t’i paguajë paditësit një shpërblim prej 1 muaj pagë për mosrespektim të afatit të njoftimit për zgjidhjen e kontratës së punës. 4. Detyrimin e palës së paditur t’i paguajë paditësit një dëmshpërblim prej 2 muajsh pagë për mosrespektim të procedurës për zgjidhjen e kontratës së punës. 5. Rrëzimin për pjesën tjetër të kërkesëpadisë.”.

2. **Gjykata Administrative e Apelit me Vendimin nr. 1943, datë 20.06.2019** ka vendosur: “- Ndryshimin e Vendimit nr. 94 (101), datë 04.02.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë. – Pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë. – Detyrimin e palës së paditur t’i paguajë paditësit, Morande Hoxha, pagën për periudhën 10.10.2013 – 31.12.2013. – Rrëzimin e padisë për kërkimet e tjera. – Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës së paditur.”.

3. Kundër Vendimit nr. 1943, datë 20.06.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit ka ushtruar rekurs pala e paditur, Agjencia Shtetërore e Kadastrës. Në rekurs është kërkuar ndryshimi i vendimeve të dy gjykatave të faktit dhe rrëzimi i padisë si e pabazuar në ligj.

4. **Me datë 07.10.2019 Agjencia Shtetërore e Kadastrës ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë.** Në kërkesë parashtrohet se:

- *Ndaj vendimit të gjykatës së apelit është ushtruar rekurs;*
- *Bazuar në nenin 479 të Kodit të procedurës Civile vendimi objekt rekursi duhet të pezullohet dhe të mosekzekutohet.*

2. VLERËSIMI I KOLEGJIT ADMINISTRATIV TË GJYKATËS SË LARTË

5. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi

masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

6. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atëçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

7. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:

a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme; dhe/ose

b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.

8. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të pariparueshëm dhe të atëçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;
- (nuk) cenohet rëndë interesi publik.

9. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të inicuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

10. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentat e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim.

11. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim. Nga ana tjetër abuzimi me mjetin ligjor të parashikuar nga neni 479 i Kodit të Procedurës Civile mund të shkaktojë dhe aktivizimin e përgjegjësive personale pasurore të palës apo përfaqësuesit, sipas pikës 1 të nenit 34 të Kodit.

12. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë është e pabazuar në ligj dhe si e tillë nuk duhet të pranohet. Gjykata e Lartë konstaton se shkaqet e rekursit janë paraqitur si shkaqe të kërkesës për pezullimin e vendimit të formës së prerë dhe për rrjedhojë kërkesa për pezullim nuk paraqet shkaqe të përligjura dhe që mundet të shqyrtohen në këtë gjykim të posaçëm të masave të përkohshme procedurale. Nga ana tjetër pala kërkuese nuk ka paraqitur argumentet dhe provat konkrete për vërtetimin e dëmit të riparueshëm dhe të atëçastshëm që palës debitore mund t'i vijë nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Për rrjedhojë Kolegji konkludon se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë nuk mund të pranohet, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile.

PËR KËTO ARSYE:

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë mbështetur në Nenin 479 të Kodit të Procedurës Civile,

VENDOSI:

Mospranimin e kërkesës për pezullim të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës kundër Vendimit Nr. 94, datë 04.02.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, lënë në fuqi me Vendimin nr. 1943, datë 20.06.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit.

Tiranë, me datë 04.05.2020

ANËTAR

ILIR PANDA

ANËTAR

ERVIN PUPE

KRYESUES

SOKOL SADUSHI



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

Nr. 14/269 Regjistri.

VENDIM

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

**SOKOL SADUSHI
ERVIN PUPE
ILIR PANDA**

**KRYESUES
ANËTAR
ANËTAR**

Sot më datë 04.05.2020, mori në shqyrtim në dhomë këshillimi kërkesën Nr. 1398 Prot., datë 07.05.2019, si më poshtë:

KËRKUES: **MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË**

PADITËS: **Z. PANDELI BEGA**

I PADITUR: **MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË**

OBJEKTI: Kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të Vendimit nr. 1053, datë 30.11.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, lënë në fuqi me Vendimin nr. 4482, datë 11.12.2018 të Gjykatës Administrative të Apelit.

BAZA LIGJORE: Neni 479 i Kodit të Procedurës Civile.

Gjykata Administrative të Shkallës së Parë Durrës me Vendimin nr. 1053 (82-2016-1628), datë 30.11.2016 ka vendosur: “- *Pranimin e kërkesë-padisë. – Kompensimin për paraburgim të padrejtë të paditësit për 213 ditë, në shumën totale 639.000 Lekë.*”.

Gjykata Administrative e Apelit me Vendimin nr. 4482, datë 11.12.2018 ka vendosur: “- *Lënien në fuqi të Vendimit nr. 1053, datë 30.11.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës.*”.

Kundër Vendimit nr. 4482, datë 11.12.2018 të Gjykatës Administrative të Apelit ka ushtruar rekurs pala e paditur, Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Në rekurs është kërkuar prishja e vendimit të gjykatës së apelit dhe vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe rrezimin e padisë si të pazuar në ligj.

Me datë 07.05.2019 Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë. Në kërkesë parashtrohet se:

- *Procedurat e ekzekutimit të detyrueshëm kanë nisur;*
- *Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka ushtruar rekurs kundër vendimit dhe çështja pritet të gjykohet në Gjykatën e Lartë;*
- *Gjykatat kanë gabuar në caktimin e dëmshpërblimit, pasi nuk kanë zbatuar kriteret ligjore;*
- *Nëse vendimi gjyqësor ekzekutohet atëhere do të rrezikohet veprimtaria e institucionit dhe nuk do munden të përmbushen shërbimet dhe detyrimet ligjore kundrejt qytetarëve;*
- *Nuk ka buxhet të planifikuar për ekzekutimin e këtij vendimi gjyqësor dhe se vendimi duhet të pezullohet, deri në shqyrtimin e rekursit nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë.*

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë

Pasi dëgjoji relatimin e gjyqtarit, z. **Sokol Sadushi**, mbi kërkesën e pezullimit të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë,

VËREN:

1. Faktet e çështjes

1. **Gjykata Administrative të Shkallës së Parë Durrës me Vendimin nr. 1053 (82-2016-1628), datë 30.11.2016** ka vendosur: “- *Pranimin e kërkesë-padisë. – Kompensimin për paraburgim të padrejtë të paditësit për 213 ditë, në shumën totale 639.000 Lekë.*”.

2. **Gjykata Administrative e Apelit me Vendimin nr. 4482, datë 11.12.2018** ka vendosur: “- *Lënien në fuqi të Vendimit nr. 1053, datë 30.11.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës.*”.

3. Kundër Vendimit nr. 4482, datë 11.12.2018 të Gjykatës Administrative të Apelit ka ushtruar rekurs pala e paditur, Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Në rekurs është kërkuar prishja e vendimit të gjykatës së apelit dhe vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe rrezimin e padisë si të pabazuar në ligj.

4. **Me datë 07.05.2019 Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë. Në kërkesë parashtrohet se:**

- *Procedurat e ekzekutimit të detyrueshëm kanë nisur;*
- *Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka ushtruar rekurs kundër vendimit dhe çështja pritet të gjykohet në Gjykatën e Lartë;*
- *Gjykatat kanë gabuar në caktimin e dëmshpërblimit, pasi nuk kanë zbatuar kriteret ligjore;*
- *Nëse vendimi gjyqësor ekzekutohet atëhere do të rrezikohet veprimtaria e institucionit dhe nuk do munden të përmbushen shërbimet dhe detyrimet ligjore kundrejt qytetarëve;*
- *Nuk ka buxhet të planifikuar për ekzekutimin e këtij vendimi gjyqësor dhe se vendimi duhet të pezullohet, deri në shqyrtimin e rekursit nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë.*

5. Rezulton se përmbaruesi gjyqësor ka realizuar njoftimin e debitorit për ekzekutimin vullnetar e më tej ka nisur ekzekutimi i detyrueshëm. Kolegji Administrativ i Gjykatës së

Lartë ka vendosur të procedojë me njoftimin e palëve për kërkesën e palës së paditur për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë.

2. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

6. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

7. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atçastshëm dhe eminent për shkakimin e një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

8. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:

a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme; dhe/ose

b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.

9. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Koncretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të pariparueshëm dhe të atçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;
- (nuk) cenohet rëndë interesi publik.

10. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të inicuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

11. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një

dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentat e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim.

12. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim. Nga ana tjetër abuzimi me mjetin ligjor të parashikuar nga neni 479 i Kodit të Procedurës Civile mund të shkaktojë dhe aktivizimin e përgjegjësive personale pasurore të palës apo përfaqësuesit, sipas pikës 1 të nenit 34 të Kodit.

13. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në funksion të zgjidhjes së çështjes konkrete, vlerëson se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë e paraqitur nga pala e paditur është e pabazuar në ligj dhe si e tillë nuk duhet të pranohet. Pala kërkuese nuk ka paraqitur argumentet dhe provat konkrete për vërtetimin e dëmit të riparueshëm dhe të atëçastshëm që palës debitore mund t'i vijë nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Për rrjedhojë Kolegji vlerëson se kërkesa nuk bazohet në nenin 479 të Kodit të Procedurës Civile dhe si e tillë nuk duhet të pranohet.

PËR KËTO ARSYE:

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë mbështetur në Nenin 479 të Kodit të Procedurës Civile,

VENDOSI:

Mospranimin e kërkesës për pezullim të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë kundër Vendimit nr. 1053 (82-2016-1628), datë 30.11.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, të ndryshuar me Vendimin nr. 4482, datë 11.12.2018 të Gjykatës Administrative të Apelit.

Tiranë, me datë 04.05.2020

ANËTAR

ILIR PANDA

ANËTAR

ERVIN PUPE

KRYESUES

SOKOL SADUSHI



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

Nr. 88/414 Regjistri.

VENDIM

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

**SOKOL SADUSHI
ERVIN PUPE
ILIR PANDA**

**KRYESUES
ANËTAR
ANËTAR**

Sot më datë 04.05.2020, mori në shqyrtim në dhomë këshillimi kërkesën Nr. 2231 Prot., datë 09.09.2019, si më poshtë:

KËRKUES: **MINISTRIA E FINANCAVE DHE E EKONOMISË
DEGA E THESARIT TIRANË**

PADITËS: **Z. PETRIT HOXHA**

I PADITUR: **MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DEGA E THESARIT**

PERSON I TRETË: **PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR
TIRANË**

OBJEKTI: Kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të Vendimit nr. 1298, datë 25.04.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

BAZA LIGJORE: Neni 479 i Kodit të Procedurës Civile.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me Vendimin Nr. 6443 (80-2015-4726), datë 21.12.2015 ka vendosur ndër të tjera: “- *Pranimin e kërkesë padisë së paditësit Petrit Hoxha. – Detyrimin e palëve të paditura të kompensojnë paditësin, Petrit Hoxha, për ditët e paraburgimit të vuajtura në mënyrë të padrejtë prej tij në periudhën 13.02.2014 – 21.01.2015, konkretisht 342 ditë x 3000 Lekë/dita = 1.026.00 Lekë.*”.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me Vendimin nr. 59 (31135-03713-80) Regjistri Themeltar, datë 20.06.2019 ka vendosur ndër të tjera: “- *Pranimin e kërkesës së kërkesit Petrit Hoxha. – Korrigjimin e gabimit material në Vendimin nr. 6443 (80-2015-4726, datë 21.12.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me Vendimin nr. 1298, datë 25.04.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë për sa i përket shumës totale të kompensimit që palët e paditura detyrohen ti paguajnë*

paditësit Petrit Hoxha nga ajo e shënuar gabim në vendim 1.026.00 Lekë, në atë të saktë 1.026.000 Lekë. – Ky vendim i bashkohet vendimit të ndrequr nr. 6443 (80-2015-4726), datë 21.12.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe është pjesë përbërëse e tij..”.

Gjykata Administrative e Apelit me Vendimin nr. 1298, datë 25.04.2019 ka vendosur: *“Lënien në fuqi të Vendimit nr. 6443 (4726), datë 21.12.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.”.*

Kundër Vendimit nr. 1298, datë 25.04.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit ka ushtruar rekurs pala e paditur, Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Në rekurs është kërkuar ndryshimi i vendimeve të të dy gjykatave të faktit dhe rrezimi i padisë si e pabazuar në ligj për sa i përket masës së dëmshpërblimit.

Me datë 09.09.2019 Ministria e Financave dhe e Ekonomisë ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë. Në kërkesë parashtrohet se:

- *Duke qenë se kanë nisur procedurat e ekzekutimit të detyrueshëm dhe çështja pret një zgjidhje përfundimtare, atëhere duhet që Gjykata e Lartë të pezullojë vendimin gjyqësor të formës së prerë, derisa të zgjidhet çështja;*
- *Masa e dëmshpërblimit e caktuar nga gjykata nuk ka respektuar Vendimin e Këshillit të Ministrave për pagën minimale në shkallë vendi dhe Vendimin Unifikues nr. 3, datë 27.03.2003 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë;*
- *Nëse vendimi gjyqësor ekzekutohet atëhere do të rrezikohet veprimtaria e institucionit dhe nuk do munden të përmbushen shërbimet dhe detyrimet ligjore kundrejt qytetarëve;*
- *Nuk ka buxhet të planifikuar për ekzekutimin e këtij vendimi gjyqësor dhe se vendimi duhet të pezullohet, deri në shqyrtimin e rekursit nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë.*

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoi relatimin e gjyqtarit, z. **Sokol Sadushi**, mbi kërkesën e pezullimit të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë,

VËREN:

1. FAKTET E ÇËSHTJES

1. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me Vendimin Nr. 6443 (80-2015-4726), datë 21.12.2015 ka vendosur ndër të tjera: *“- Pranimin e kërkesë padisë së paditësit Petrit Hoxha. – Detyrimin e palëve të paditura të kompensojnë paditësin, Petrit Hoxha, për ditët e paraburgimit të vuajtura në mënyrë të padrejtë prej tij në periudhën 13.02.2014 – 21.01.2015, konkretisht 342 ditë x 3000 Lekë/dita = 1.026.00 Lekë.”.*

2. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me Vendimin nr. 59 (31135-03713-80) Regjistri Themeltar, datë 20.06.2019 ka vendosur ndër të tjera: *“- Pranimin e kërkesës së kërkuarit Petrit Hoxha. – Korrigjimin e gabimit material në Vendimin nr. 6443 (80-2015-4726, datë 21.12.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me Vendimin nr. 1298, datë 25.04.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë për sa i përket shumës totale të kompensimit që palët e paditura detyrohen ti paguajnë*

paditësit Petrit Hoxha nga ajo e shënuar gabim në vendim 1.026.00 Lekë, në atë të saktë 1.026.000 Lekë. – Ky vendim i bashkohet vendimit të ndrequr nr. 6443 (80-2015-4726), datë 21.12.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe është pjesë përbërëse e tij..”.

3. **Gjykata Administrative e Apelit me Vendimin nr. 1298, datë 25.04.2019** ka vendosur: “Lënien në fuqi të Vendimit nr. 6443 (4726), datë 21.12.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.”.

4. Kundër Vendimit nr. 1298, datë 25.04.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit ka ushtruar rekurs pala e paditur, Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Në rekurs është kërkuar ndryshimi i vendimeve të të dy gjykatave të faktit dhe rrezimi i padisë si e pabazuar në ligj përse i përket masës së dëmshpërblimit.

5. **Me datë 09.09.2019 Ministria e Financave dhe e Ekonomisë ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë.** Në kërkesë parashtrohet se:

- Duke qenë se kanë nisur procedurat e ekzekutimit të detyrueshëm dhe çështja pret një zgjidhje përfundimtare, atëhere duhet që Gjykata e Lartë të pezullojë vendimin gjyqësor të formës së prerë, derisa të zgjidhet çështja;
- Masa e dëmshpërblimit e caktuar nga gjykata nuk ka respektuar Vendimin e Këshillit të Ministrave për pagën minimale në shkallë vendi dhe Vendimin Unifikues nr. 3, datë 27.03.2003 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë;
- Nëse vendimi gjyqësor ekzekutohet atëhere do të rrezikohet veprimtaria e institucionit dhe nuk do munden të përmbushen shërbimet dhe detyrimet ligjore kundrejt qytetarëve;
- Nuk ka buxhet të planifikuar për ekzekutimin e këtij vendimi gjyqësor dhe se vendimi duhet të pezullohet, deri në shqyrtimin e rekursit nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë.

6. Rezulton se përmbaruesi gjyqësor ka realizuar njoftimin e debitorit për ekzekutimin vullnetar. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur të procedojë me njoftimin e palëve për kërkesën e palës së paditur për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë.

2. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

7. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

8. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

9. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:

a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme; dhe/ose

b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.

10. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të pariparueshëm dhe të atëçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;
- (nuk) cenohet rëndë interesi publik.

11. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të inicuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

12. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentat e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim.

13. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim. Nga ana tjetër abuzimi me mjetin ligjor të parashkuar nga neni 479 i Kodit të Procedurës Civile mund të shkaktojë dhe aktivizimin e përgjegjësive personale pasurore të palës apo përfaqësuesit, sipas pikës 1 të nenit 34 të Kodit.

14. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë është e pabazuar në ligj dhe si e tillë nuk duhet të pranohet. Gjykata e Lartë konstaton se shkaqet e rekursit janë paraqitur si shkaqe të kërkesës për pezullimin e vendimit të formës së prerë dhe për rrjedhojë kërkesa për pezullim nuk paraqet shkaqe të përlegjura dhe që mundet të shqyrtohen në këtë gjykim të posaçëm të masave të përkohshme procedurale. Nga ana tjetër pala kërkuese nuk ka paraqitur argumentet dhe provat konkrete për vërtetimin e dëmit të pariparueshëm dhe të atëçastshëm që palës debitore mund t'i vijë nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Për rrjedhojë Kolegji konkludon se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë nuk mund të pranohet, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile.

PËR KËTO ARSYE:

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë mbështetur në Nenin 479 të Kodit të Procedurës Civile,

VENDOSI:

Mospranimin e kërkesës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për pezullimin e ekzekutimit të Vendimit Nr. 6443 (80-2015-4726), datë 21.12.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, të korrigjuar me Vendimin nr. 59 (31135-03713-80) Regjistri Themeltar, datë 20.06.2019 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, i lënë në fuqi me Vendimin nr. 1298, datë 25.04.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit.

Tiranë, me datë 04.05.2020

ANËTAR

ILIR PANDA

ANËTAR

ERVIN PUPE

KRYESUES

SOKOL SADUSHI



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

Nr. 137/492 Regjistri.

VENDIM

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

**SOKOL SADUSHI
ERVIN PUPE
ILIR PANDA**

**KRYESUES
ANËTAR
ANËTAR**

Sot më datë 04.05.2020, mori në shqyrtim në dhomë këshillimi kërkesat nr. 492 regjistri, datë 11.11.2019, si më poshtë:

Kërkues: **Bashkia Tiranë**

PADITËS: **Xhavit Hasanaj**

I PADITUR: **BASHKIA TIRANË**

Objekti: Pezullimi i ekzekutimit të Vendimit nr. 9514, datë 12.01.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë i ndryshuar me Vendimin nr. 790, datë 18.03.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit.

Baza ligjore: Neni 449, 479/a i Kodit të Procedurës Civile.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me Vendimin nr. 9514, datë 12.01.2012 ka vendosur ndër të tjera: *“Pranimin pjesërisht të padisë. Detyrimin e palës së paditur, Bashkia Tiranë, t’i paguajë palës paditëse, Xhavit Hasanaj, si dëmshpërblim pagën e 8 muajve punë për shkak të zgjidhjes së menjëhershme të pajustificuar të kontratës së punës. Detyrimin e palës së paditur, Bashkia Tiranë, t’i paguajë paditësit, Xhavit Hasanaj, si dëmshpërblim pagën e 2 muajve punë për shkak të mosrespektimit të afatit të njoftimit për zgjidhjen e kontratës së punës. Detyrimin e palës së paditur, Bashkia Tiranë, t’i paguajë paditësit, Xhavit Hasanaj, pagën e 5 (pesë) muajve punë si shpërblim për vjetërsi në punë.”.*

Gjykata Administrative e Apelit me Vendimin nr. 790, datë 18.03.2019 ka vendosur: *“Ndryshimin e Vendimit nr. 9514, datë 12.10.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në këtë mënyrë: Pranimin e pjesshëm të padisë. Shfuqizimin e Urdhrit nr. 1586/1, datë 21.10.2011 të Krzetarit të Bashkisë Tiranë në lidhje me lirimimin e paditësit, Xhavit Hasanaj nga detyra e punonjësit të policisë bashkiake në Bashkinë Tiranë. Detyrimin e palës së paditur, Bashkia Tiranë, ta dëmshpërblejë paditësin me 12 paga mujore. Rrëzimin e pjesës tjetër të objektit të padisë. Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës së paditur.”.*

Pala e paditur, Bashkia Tiranë, ka ushtruar rekurs kundër vendimit të gjykatës së apelit, duke parashtruar edhe shkaqet respektive të kundërshtimit ligjor dhe duke kërkuar ndryshimin e të dy vendimeve të gjykatave të faktit dhe rrëzimin e padisë si të pabazuar në ligj dhe në prova.

Me datë 11.11.2019 pala e paditur, Bashkia Tiranë, ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë.

Në kërkesë parashtrohet se:

- *Ekzekutimi i vendimit gjyqësor do të sillte pasoja të rënda për buxhetin dhe se ky zë financiar nuk është parashikuar tek buxheti i këtij viti;*
- *Ka pamundësi më vonë që kjo shumë e dalë nga buxheti i shtetit të kthehet sërish mbrapsht;*
- *Procedura e largimit dhe shkaqet e largimit nga detyra janë respektuar sipas ligjit;*
- *Ekzekutimi i titullit ekzekutiv ka nisur dhe se ka nevojë që ai të mos vazhdojë dhe vendimi të mos ekzekutohet derisa Gjykata e Lartë të shqyrtojë rekursin;*
- *Vendimi duhet të pezullohet, deri në shqyrtimin e rekursit nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë.*

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë

Pasi dëgjoi relatimin e gjyqtarit z. **Sokol Sadushi** mbi kërkesën e pezullimit të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë,

VËREN:

1. Faktet e çështjes

1. **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me Vendimin nr. 9514, datë 12.01.2012** ka vendosur ndër të tjera: *“Pranimin pjesërisht të padisë. Detyrimin e palës së paditur, Bashkia Tiranë, t’i paguajë palës paditëse, Xhavit Hasanaj, si dëmshpërblim pagën e 8 muajve punë për shkak të zgjidhjes së menjëhershme të pajustificuar të kontratës së punës. Detyrimin e palës së paditur, Bashkia Tiranë, t’i paguajë paditësit, Xhavit Hasanaj, si dëmshpërblim pagën e 2 muajve punë për shkak të mosrespektimit të afatit të njoftimit për zgjidhjen e kontratës së punës. Detyrimin e palës së paditur, Bashkia Tiranë, t’i paguajë paditësit, Xhavit Hasanaj, pagën e 5 (pesë) muajve punë si shpërblim për vjetërsi në punë.”.*

2. **Gjykata Administrative e Apelit me Vendimin nr. 790, datë 18.03.2019** ka vendosur: *“Ndryshimin e Vendimit nr. 9514, datë 12.10.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në këtë mënyrë: Pranimin e pjesshëm të padisë. Shfuqizimin e Urdhrit nr. 1586/1, datë 21.10.2011 të Krzetarit të Bashkisë Tiranë në lidhje me lirimin e paditësit, Xhavit Hasanaj nga detyra e punonjësit të policisë bashkiake në Bashkinë Tiranë. Detyrimin e palës së paditur, Bashkia Tiranë, ta dëmshpërblejë paditësin me 12 paga mujore. Rrëzimin e pjesës tjetër të objektit të padisë. Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës së paditur.”.*

3. Pala e paditur, Bashkia Tiranë, ka ushtruar rekurs kundër vendimit të gjykatës së apelit, duke parashtruar edhe shkaqet respektive të kundërshtimit ligjor dhe duke kërkuar ndryshimin e të dy vendimeve të gjykatave të faktit dhe rrëzimin e padisë si të pabazuar në ligj dhe në prova.

4. Me datë 11.11.2019 pala e paditur, Bashkia Tiranë, ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë. Në kërkesë parashtrohet se:

- Ekzekutimi i vendimit gjyqësor do të sillte pasoja të rënda për buxhetin dhe se ky zë financiar nuk është parashikuar tek buxheti i këtij viti;
- Ka pamundësi më vonë që kjo shumë e dalë nga buxheti i shtetit të kthehet sërish mbrapsht;
- Procedura e largimit dhe shkaqet e largimit nga detyra janë respektuar sipas ligjit;
- Ekzekutimi i titullit ekzekutiv ka nisur dhe se ka nevojë që ai të mos vazhdojë dhe vendimi të mos ekzekutohet derisa Gjykata e Lartë të shqyrtojë rekursin;
- Vendimi duhet të pezullohet, deri në shqyrtimin e rekursit nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë.

5. Ekzekutimi i detyrueshëm ka nisur për titullin ekzekutiv. Kolegji ka proceduar me njoftimet e palëve para se kërkesa për pezullim të shqyrtohet.

2. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

6. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

7. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

8. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:

a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme; dhe/ose

b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.

9. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor,

respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të riparueshëm dhe të atëçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;
- (nuk) cenohet rëndë interesi publik.

10. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimit nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të inicuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

11. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentat e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim.

12. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim. Nga ana tjetër abuzimi me mjetin ligjor të parashikuar nga neni 479 i Kodit të Procedurës Civile mund të shkaktojë dhe aktivizimin e përgjegjësisë personale pasurore të palës apo përfaqësuesit, sipas pikës 1 të nenit 34 të Kodit.

13. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë është e pabazuar në ligj dhe si e tillë nuk duhet të pranohet. Gjykata e Lartë konstaton se shkaqet e rekursit janë paraqitur si shkaqe të kërkesës për pezullimin e vendimit të formës së prerë dhe për rrjedhojë kërkesa për pezullim nuk paraqet shkaqe të përligjura dhe që mundet të shqyrtohen në këtë gjykim të posaçëm të masave të përkohshme procedurale. Nga ana tjetër pala kërkuese nuk ka paraqitur argumentet dhe provat konkrete për vërtetimin e dëmit të riparueshëm dhe të atëçastshëm që palës debitorë mund t'i vijë nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Për rrjedhojë Kolegji konkludon se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë nuk mund të pranohet, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile.

Për këto arsye:

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë mbështetur në Nenin 479 të Kodit të Procedurës Civile,

Vendosi:

Mospranimin e kërkesës për pezullim të palës së paditur, Bashkia Tiranë, ndaj Vendimit nr. 9514, datë 12.01.2012 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, i ndryshuar me Vendimin nr. 790, datë 18.03.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit.

Tiranë, me datë 04.05.2020

ANËTAR

ILIR PANDA

ANËTAR

ERVIN PUPE

KRYESUES

SOKOL SADUSHI



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

Nr. 123/464 Regjistri.

VENDIM

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

**SOKOL SADUSHI
ERVIN PUPE
ILIR PANDA**

**KRYESUES
ANËTAR
ANËTAR**

Sot më datë 04.05.2020, mori në shqyrtim në dhomë këshillimi kërkesën Nr. 464 Regjistri, datë 10.10.2019, si më poshtë:

KËRKUES: Y. SALLA SH.P.K.

PADITËS: Y. SALLA SH.P.K.

I PADITUR: DREJTORIA RAJONALE TATIMORE ELBASAN
DREJTORIA E APELIT TATIMOR PRANË DREJTORISË SË
PËRGJITHSHME TË TATIMEVE

OBJEKTI: Pezullim i ekzekutimit të Vendimit nr. 1186, datë 18.04.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

BAZA LIGJORE: Neni 479 i Kodit të Procedurës Civile.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës me Vendimin Nr. 537, datë 28.04.2015 ka vendosur ndër të tjera: “*1. Rrëzimin e kërkesë-padisë.*”.

Gjykata Administrative e Apelit me Vendimin nr. 1186, datë 18.04.2019 ka vendosur: “*- Lënien në fuqi të Vendimit nr. 537, datë 28.04.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës.*”.

Kundër Vendimit **nr. 1186, datë 18.04.2019** të Gjykatës Administrative të Apelit ka ushtruar rekurs pala paditëse. Në rekurs është kërkuar ndryshimi i vendimeve të dy gjykatave të faktit dhe pranimin e padisë sipas objektit.

Me datë 10.10.2019 pala paditëse ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë. Në kërkesë parashtrohet se:

- *Ndaj vendimit të gjykatës së apelit është ushtruar rekurs;*

- Bazuar në nenin 479 të Kodit të procedurës Civile vendimi objekt rekursi duhet të pezullohet dhe të mosekzekutohet;
- Vendimet e gjykatave të faktit janë të pabazuara në ligj dhe duhet të ndryshohen.

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoji relatimin e gjyqtarit, z. **Sokol Sadushi**, mbi kërkesën e pezullimit të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë,

VËREN:

1. FAKTET E ÇËSHTJES

1. **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës me Vendimin Nr. 537, datë 28.04.2015** ka vendosur ndër të tjera: “1. Rrëzimin e kërkesë-padisë.”.

2. **Gjykata Administrative e Apelit me Vendimin nr. 1186, datë 18.04.2019** ka vendosur: “- Lënien në fuqi të Vendimit nr. 537, datë 28.04.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës.”.

3. Kundër Vendimit **nr. 1186, datë 18.04.2019** të Gjykatës Administrative të Apelit ka ushtruar rekurs pala paditëse. Në rekurs është kërkuar ndryshimi i vendimeve të dy gjykatave të faktit dhe pranimin e padisë sipas objektit.

4. **Me datë 10.10.2019 pala paditëse ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë.** Në kërkesë parashtrohet se:

- Ndaj vendimit të gjykatës së apelit është ushtruar rekurs;
- Bazuar në nenin 479 të Kodit të procedurës Civile vendimi objekt rekursi duhet të pezullohet dhe të mosekzekutohet;
- Vendimet e gjykatave të faktit janë të pabazuara në ligj dhe duhet të ndryshohen.

2. VLERËSIMI I KOLEGJIT ADMINISTRATIV TË GJYKATËS SË LARTË

5. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënie të vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

6. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

7. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit

gjqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:

a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme; dhe/ose

b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.

8. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të pariparueshëm dhe të atëçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;
- (nuk) cenohet rëndë interesi publik.

9. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të inicuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

10. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentat e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim.

11. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim. Nga ana tjetër abuzimi me mjetin ligjor të parashkuar nga neni 479 i Kodit të Procedurës Civile mund të shkaktojë dhe aktivizimin e përgjegjësive personale pasurore të palës apo përfaqësuesit, sipas pikës 1 të nenit 34 të Kodit.

12. Duke iu kthyer rastit konkret, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë është haptazi e pabazuar në ligj dhe si e tillë nuk duhet të pranohet. Njëkohësisht kërkesa objekt gjykimi konstatohet se është haptazi abuzive, pasi konstatohet se në këtë çështje është vendosur rrëzimi i padisë nga gjykata e shkallës së parë dhe se në gjykimin në apelit ky vendim është lënë në fuqi. Pikërisht ky vendim i gjykatës së apelit rekursohet nga pala paditëse dhe se kërkesa për pezullimin e ekzekutimit ka pikërisht këtë vendim të gjykatës së apelit si objekt.

13. Kolegji Administrativ sjellë në vëmendje se si rregull i përgjithshëm vendimet e rrëzimit të padisë nuk mund të përbëjnë tituj ekzekutiv sipas nenit 510 shkronja “a” të Kodit të Procedurës Civile dhe se për rrjedhojë përjashtohet apriori mundësia që ato të ekzekutohen dhe të sjellin rrezik apo pasoja të parikuperueshme në të drejtat subjektive dhe interesat e ligjshëm të palës rekursuese dhe njëkohësisht kërkuese. Duke qenë se kjo kërkesë është

haptazi e pathemeltë dhe për më tepër abuzive, Kolegji Administrativ vlerëson se është vendi të procedohet me zbatimin e pikës 1 të nenit 34 të Kodit të Procedurës Civile.

14. Pika 1 e neni 34 të Kodit të Procedurës Civile parashikon se:

“1. Gjykata, në çdo shkallë të gjykimit, kur konstaton se palët ose përfaqësuesit e tyre me vetëdije paraqesin padi, ankime, kërkesa ose pretendime abuzive, ose të përsëritura dhe me keqdashje, ose kur kërkojnë qëllimisht të zvarrisin gjykimin, ose kur konstatohet se palët ose përfaqësuesit e tyre kanë fshehur ose shtrembëruar me keqbesim ose faj të rëndë, fakte dhe rrethana të rëndësishme që lidhen me çështjen, urdhëron me vendimin që jepet në përfundim të gjykimit, përveç kur në këtë Kod parashikohet ndryshe, gjorbitjen e përgjegjësit në shumën nga 50 000 deri në 100 000 lekë. Kundër këtij vendimi lejohet ankim sipas rregullave për vendimet përfundimtare ose jopërfundimtare, në varësi të llojit të vendimit që i jep fund gjykimit përkatës.”

15. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se kjo pjesë e dispozitës ka synuar të aktivizojë përgjegjësinë e palëve dhe përfaqësuesve të tyre të cilët abuzojnë me të drejtat procedurale. Mjetet procedurale dhe të drejtat që ligji ofron nuk mund të pranohen të lejojnë dëmtimin e procesit të dhënies së drejtësisë. Ato nuk mund të shndërrohen në mekanizma që palët dhe përfaqësuesit e tyre t'i përdorin me keqbesim apo me qëllime të pamundësisë së zhvillimit të procesit apo dëmtimit të interesave dhe të drejtës së palës kundërshtare për të gëzuar efektivisht aksesin në drejtësi. Për rrjedhojë sa herë që konstatohen fakte të tilla të paligjshme në mënyrën se si një ndërgjyqës mbrohet apo e ushtron aktivitetin procedural gjykata duhet të sanksionojë përgjegjësinë pasurore për shkelje të këtij detyrimi ligjor. Qëllimi i kësaj norme është garantimi i mbarëvajtjes së procesit gjyqësor dhe detyrimi i subjekteve procedurale, qoftë ndërgjyqës apo qoftë përfaqësues, që të veprojnë dhe të ushtrojnë me mirëbesim të drejtat procedurale.

16. Gjykimi në Gjykatën e Lartë në këtë drejtim paraqet dy veçanti.

17. Fillimisht duhet të mbahet parasysh se neni 474 i Kodit të Procedurës Civile parashikon se rekursi i paraqitur në Gjykatën e Lartë duhet të nënshkruhet nga avokati që e përfaqëson palën dhe nëse pala e kërkon, edhe nga kjo e fundit. Nga ana tjetër neni 59 i Ligjit nr. 49/2012 parashikon se edhe kundërrkursi duhet të plotësojë kushtet formale që paraqet rekursi. Kjo do të thotë se qoftë mjetet e ankimit dhe qoftë mjetet e prejardhura të ankimit do të duhet të realizohen nga avokati në Gjykatën e Lartë, si një gjykatë ekskluzivisht me juridiksion të posaçëm ligjor. Nga këto parashikime konkludohet se aktet që i drejtohen Gjykatës së Lartë dhe që përbëjnë disponim të të drejtave procedurale të palëve aktivizojnë detyrimisht edhe përgjegjësinë e përfaqësuesit të palës. Ndaj këto të fundit janë personalisht përgjegjës sipas nenit 34 të Kodit të Procedurës Civile.

18. Nga ana tjetër, gjykimi në Gjykatën e Lartë, në rastin e zbatimit të sanksionit të parashikuar në nenin 34, pika 1 të Kodit të Procedurës Civile, nuk mundëson ushtrimin e ankimit të veçantë ndaj gjobës prej 50.000 Lekë – 100.000 Lekë që kjo gjykatë vendos. Në këto raste ankimi i veçantë që kjo dispozitë ofron nuk mund të zbatohet, pasi vendimi i Gjykatës së Lartë sipas nenit 482 dhe 485 të Kodit të Procedurës Civile dhe nenit 60/a dhe 63 të Ligjit nr. 49/2012 nuk mund të ankimohet gjyqësisht duke qenë se pushteti gjyqësor shteron pas ezaurimit të kësaj shkalle gjykimi.

19. Megjithatë Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se një palë apo përfaqësues i dënuar proceduralisht sipas pikës 1 të nenit 34 të Kodit të Procedurës Civile duhet të ketë mundësi të dëgjohet dhe të mbrohet lidhur me këtë sanksion, por se ligji procedural ka ometuar të japë një zgjidhje ligjore eksplicite në këtë drejtim. Me qëllimin që ndërgjyqësi apo përfaqësuesi i tij - i sanksionuar proceduralisht me gjobë për abuzim me të drejtat procedurale – të ketë mundësinë e një ankimi dhe mbi të gjitha të ketë mundësi të mbrohet mbi këtë vendim të Gjykatës së Lartë, Kolegji Administrativ vlerëson të nevojshme që nëpërmjet interpretimit pajtues të ligjit, që është në funksion të respektimit të së drejtës

kushtetuese, të mos pengojë mundësinë e ankimit në gjykatë, për këto raste. Në bazë dhe për zbatim të paragrafit të dytë të nenit 1 të Kodit të Procedurës Civile, Kolegji Administrativ vlerëson se si zgjidhje në këtë rast duhet të ofrohet mjeti i posaçëm i ankimit i parashikuar në nenin 169 të Kodit të Procedurës Civile. Kjo dispozitë nën titullin “*Kundërshtimi i vendimit të dënimit*” parashikon se:

“Personat që janë dënuar me gjobë, sipas dispozitave të mësipërme, mund t’i paraqitin gjykatës që i ka dënuar, brenda tri ditëve, kërkesë për heqjen e dënimit, duke treguar dhe shkaqet.

Gjykata kur i gjen me vend këto shkaqe, revokon vendimin e dënimit me gjobë si dhe urdhrin e sjelljes me detyrim. Ajo mund edhe vetëm të pakësojë gjobën e caktuar. Në rast të kundërt, refuzon kërkesën.

Afati për të paraqitur kërkesën fillon nga dita e seancës gjyqësore dhe, në rastet e parashikuara nga nenet 165 dhe 167, nga dita e njoftimit të vendimit të dënimit.

Vendimi i dhënë nga gjykata në rastet e sipërme është i formës së prerë dhe kundër tij nuk lejohet ankim.”

20. Për rrjedhojë Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë konkludon se, ndaj vendimeve të Gjykatës së Lartë, në të cilat sanksionohen dënime procedurale me gjobë për ndërgjyqësin apo përfaqësuesin e tij, sipas pikës 1 të nenit 34 të Kodit të Procedurës Civile, lejohet ankim brenda tre ditëve nga dita e nesërme e marrjes dijeni për vendimin, para të njëjtit trup gjykues që ka dhënë vendimin e dënimit, duke treguar shkaqet dhe arsyet që justifikojnë kërkesën. Gjykata e Lartë e shqyrton këtë kërkesë në dhomë këshillimi dhe sipas rastit vendos pakësimin e gjobës, pranimin apo refuzimin e kërkesës. Në çdo rast, kundër vendimit të Gjykatës së Lartë, që ka vendosur pakësimin, pranimin apo refuzimin e kërkesës, nuk lejohet ankim.

21. Në rastet e vendimmarrjes së Gjykatës së Lartë, përmes së cilave caktohet një sanksion procedural gjabor sipas pikës 1 të nenit 34 të Kodit të Procedurës Civile, një kopje e vendimit i njoftohet shërbimit përmbartimor, konkretisht Zyrës Përmbartimore Tiranë. Sipas shkronjës “a” të nenit 510 të Kodit të Procedurës Civile vendimet e Gjykatës së Lartë në këto raste përbëjnë tituj ekzekutiv dhe si të tilla janë të ekzekutueshme nga shërbimi përmbartimor gjyqësor. Këto shuma detyrimi derdhen nga subjekti i dënuar debitor për llogari të buxhetit të shtetit.

22. Në rastin konkret kërkesa për pezullim është ushtruar nga administratori i shoqërisë paditëse, z. Ylli Salla. Për rrjedhojë Kolegji Administrativ vendos që të dënojë z. Ylli Salla, në bazë dhe për zbatim të nenit 34 të Kodit të Procedurës Civile, me gjobë në vlerën 50.000 Lekë.

PËR KËTO ARSYE:

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë mbështetur në Nenin 34 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile,

VENDOSI:

Mospranimin e kërkesës për pezullim të palës paditëse, Y. Salla sh.p.k., kundër Vendimit Nr. 537, datë 28.04.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, lënë në fuqi me Vendimin nr. 1186, datë 18.04.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit.

Dënimin e administratorit të palës kërkuese, z. Ylli Salla, me gjobë në vlerën 50.000 lekë.

Ky vendim përbën titull ekzekutiv.

Ngarkohet Zyra e Përmbartimit Tiranë për ekzekutimin e gjobës për llogari të buxhetit të shtetit.

Një kopje e këtij vendimi i njoftohet edhe Zyrës së Përmbartimit Tiranë.

Kundër pjesës së vendimit të dënimit me gjobë mund të ushtrohet ankimi, brenda 3 ditëve nga dita e nesërme e marrjes dijeni të këtij vendimi, në Gjykatën e Lartë.

Tiranë, me datë 04.05.2020

ANËTAR

ILIR PANDA

ANËTAR

ERVIN PUPE

KRYESUES

SOKOL SADUSHI



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

Nr. 94/423 Regjistri.

VENDIM

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

**SOKOL SADUSHI
ERVIN PUPE
ILIR PANDA**

**KRYESUES
ANËTAR
ANËTAR**

Sot më datë 04.05.2020, mori në shqyrtim në dhomë këshillimi kërkesën Nr. 2297 Prot., datë 19.09.2019, si më poshtë:

KËRKUES: BASHKIA TIRANË

PADITËS: Z. ZAMIR HAXHIJA

I PADITUR: BASHKIA TIRANË

OBJEKTI: Pezullimin e ekzekutimit të Vendimit Nr. 4250 (80-2016-2499), datë 21.09.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, që është lënë në fuqi me Vendimin nr. 1630 (86-2019-1943), datë 30.05.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit.

BAZA LIGJORE: Neni 479 i Kodit të Procedurës Civile.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me Vendimin 4250 (80-2016-2499), datë 21.09.2016 ka vendosur ndër të tjera: *“Pranimin pjesërisht të padisë. Detyrimin e palës së paditur t’i paguajë paditësit, Zamir Haxhija, një dëmshpërblim prej 4 muaj pagë për shkak të zgjidhjes së menjëhershme të pajustificuar të kontratës së punës. Detyrimin e palës së paditur t’i paguajë paditësit një dëmshpërblim prej 1 muaj pagë për shkak të mosrespektimit të afatit të njoftimit deri në zgjidhjen e kontratës së punës. Rrëzimin e kërkesë padisë për pjesën tjetër si të pabazuar në ligj dhe në prova. Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës së paditur.”*

Gjykata Administrative e Apelit me Vendimin nr. 1630 (86-2019-1943), datë 30.05.2019 ka vendosur: *“Lëniën në fuqi të Vendimit nr. 4250 (80-2016-2499), datë 21.09.2019 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.”*

Kundër Vendimit nr. 1630 (86-2019-1943), datë 30.05.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit ka ushtruar rekurs pala e paditur Bashkia Tiranë. Në rekurs është kërkuar ndryshimi i vendimeve të të dy gjykatave të faktit dhe rrëzimi i padisë si e pabazuar në ligj.

Me datë 19.09.2019 Bashkia Tiranë ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë. Në kërkesë parashtrohet se:

- *Ndaj vendimit të shkallës së dytë është ushtruar rekurs dhe se pritet të gjykohet çështja në Gjykatën e Lartë;*
- *Si rezultat i ndarjes së re territoriale dhe administrative është ndryshuar edhe organika institucionale e Bashkisë Tiranë dhe se për shkak të ristrukturimit marrëdhënia e punës është zgjidhur dhe se zgjidhja është për shkaqe të justifikuara;*
- *Ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit mundet të sjellë efekte financiare të konsiderueshme për Bashkinë e Tiranë;*
- *Nuk ka buxhet të planifikuar për ekzekutimin e këtij vendimi gjyqësor dhe se vendimi duhet të pezullohet, deri në shqyrtimin e rekursit nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë.*

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoi relatimin e gjyqtarit z. **Sokol Sadushi** mbi kërkesën e pezullimit të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë,

VËREN:

1. FAKTET E ÇËSHTJES

1. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me Vendimin 4250 (80-2016-2499), datë 21.09.2016 ka vendosur ndër të tjera: *“Pranimin pjesërisht të padisë. Detyrimin e palës së paditur t’i paguajë paditësit, Zamir Haxhija, një dëmshpërblim prej 4 muaj pagë për shkak të zgjidhjes së menjëhershme të pajustificuar të kontratës së punës. Detyrimin e palës së paditur t’i paguajë paditësit një dëmshpërblim prej 1 muaj pagë për shkak të mosrespektimit të afatit të njoftimit deri në zgjidhjen e kontratës së punës. Rrëzimin e kërkesë padisë për pjesën tjetër si të pabazuar në ligj dhe në prova. Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës së paditur.”.*

2. Gjykata Administrative e Apelit me Vendimin nr. 1630 (86-2019-1943), datë 30.05.2019 ka vendosur: *“Lëniën në fuqi të Vendimit nr. 4250 (80-2016-2499), datë 21.09.2019 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.”.*

3. Kundër Vendimit nr. 1630 (86-2019-1943), datë 30.05.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit ka ushtruar rekurs pala e paditur Bashkia Tiranë. Në rekurs është kërkuar ndryshimi i vendimeve të të dy gjykatave të faktit dhe rrëzimi i padisë si e pabazuar në ligj.

4. Me datë 19.09.2019 Bashkia Tiranë ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë. Në kërkesë parashtrohet se:

- *Ndaj vendimit të shkallës së dytë është ushtruar rekurs dhe se pritet të gjykohet çështja në Gjykatën e Lartë;*
- *Si rezultat i ndarjes së re territoriale dhe administrative është ndryshuar edhe organika institucionale e Bashkisë Tiranë dhe se për shkak të ristrukturimit marrëdhënia e punës është zgjidhur dhe se zgjidhja është për shkaqe të justifikuara;*
- *Ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit mundet të sjellë efekte financiare të konsiderueshme për Bashkinë e Tiranë;*

- Nuk ka buxhet të planifikuar për ekzekutimin e këtij vendimi gjyqësor dhe se vendimi duhet të pezullohet, deri në shqyrtimin e rekursit nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë.

5. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur të procedojë me njoftimin e palëve për kërkesën e palës së paditur për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë.

2. VLERËSIMI I KOLEGJIT ADMINISTRATIV TË GJYKATËS SË LARTË

6. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

7. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

8. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:

a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme; dhe/ose

b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.

9. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të pariparueshëm dhe të atçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;
- (nuk) cenohet rëndë interesi publik.

10. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të inicuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

11. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret

ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentat e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim.

12. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim. Nga ana tjetër abuzimi me mjetin ligjor të parashikuar nga neni 479 i Kodit të Procedurës Civile mund të shkaktojë dhe aktivizimin e përgjegjësive personale pasurore të palës apo përfaqësuesit, sipas pikës 1 të nenit 34 të Kodit.

13. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë është e pabazuar në ligj dhe si e tillë nuk duhet të pranohet. Kolegji konstaton se pala e paditur ka parashtruar në kërkesën për pezullim vetëm shkaqet për të cilat mjeti i duhur i ankimit është rekursi dhe se në këto kushte nuk mundet që kërkesa për pezullim të zëvendësojë apo të dublojë efektet juridike të rekursit dhe se këto shkaqe do të shqyrtohen sipas rregullave të zakonshme të gjykimit nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë.

14. Lidhur me pretendimin e Bashkisë Tiranë për rrezikun e shaktimit të dëmeve të konsiderueshme, Kolegji vlerëson se kjo pjesë e kërkesës nuk është e arsyetuar dhe nuk është e provuar dhe se si e tillë nuk mundet të vlerësohet se bazohet në standardet ligjore që kërkon neni 479 i Kodit të Procedurës Civile për t'u pranuar dhe për t'u caktuar nga Gjykata e Lartë një masë procedurale e përkohshme. Për rrjedhojë Kolegji konkludon se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor tashmë të formës së prerë duhet të rrezohet, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile.

PËR KËTO ARSYE:

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë mbështetur në Nenin 479 të Kodit të Procedurës Civile,

VENDOSI:

Mospranimin e kërkesës së Bashkisë Tiranë për pezullimin e ekzekutimit të Vendimit Nr. 4250 (80-2016-2499), datë 21.09.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, që është lënë në fuqi me Vendimin nr. 1630 (86-2019-1943), datë 30.05.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit.

Tiranë, me datë 04.05.2020

ANËTAR

ILIR PANDA

ANËTAR

ERVIN PUPE

KRYESUES

SOKOL SADUSHI